



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
Ministarstvo Poljoprivrede, Šumarstva i Ruralnog Razvoja
Ministry of Agriculture, Forestry And Rural Development



PROGRAMI PËR BUJQËSI
DHE ZHVILLIM RURAL 2015

UDHËZUES PËR APLIKUES


MASA 302

DIVERSIFIKIMI I FERMAVE DHE
ZHVILLIMI I BIZNESEVE



www.mbpzhr-ks.net

<http://azhb.rks-gov.net>



PËRMBAJTJA

1.	OBJEKTIVAT,PRIORITETET DHE MJETET FINANCIARETË MASËS 302.....	4
1.1	HYRJA	4
2.	OBJEKTIVAT E MASËS 302.....	5
2.1	OBJEKTIVA E PËRGJITHSHME DHE SPECIFIKE TË.....	5
3.	MJETET FINANCIARE PËR KËTË MASË	5
4.	PËRKUFIZIMET BOSHTE	6
5.	INTENSITETI DHE LARTËSIA E NDIHMËS FINANCIARE SI DHE APLIKUESIT E PRANUESHËM ..	7
5.1	INTENSITETIT I NDIHMËS.....	7
6.	KRITERET E PËRBASHKËTA TË PRANUESHMËRISË PËR MASËN	7
7.	KRITERET SPECIFIKE TË PRANUESHMËRISË	10
8.	KRITERET E PËRZGJEDHJES DHE SISTEMI I PIKËVE.....	11
9.	RREGULLAT E SHPENZIMEVE TË PRANUESHME	18
10.	NIVELI I PËRKRAHJES	18
11.	LISTA E SHPENZIMEVE INDIKATIVE PËR NËNMASA ËSHTË SI NË VIJIM	19
12.	PROMOVIMI I PËRKRAHJES.....	21
13.	SHPENZIMET E PAPANUESHME	21
14.	PROCEDURAT E APLIKIMIT.....	23
15.	DORËZIMI I APLIKACIONEVE DHE AFATI I FUNDIT	23
16.	PROCEDURA E PËRZGJEDHJES,VLERËSIMI DHE PËRZGJEDHJA E APLIKACIONEVE.....	23
17.	KONTROLLET NË TERREN.....	25
18.	RADHITJA NË LISTË E APLIKUESVE	25
19.	VENDIMI I DHËNIES SË GRANTIT DHE NJOFTIMI I APLIKUESIT	25
20.	ANKESAT	25
21.	KONTRATA ME PËRFITUESIT DHE AZHB-SË BASHKË ME PROCEDURAT E PROKURIMIT.....	26
22.	PAGESA E GRANTIT	26
23.	MONITORIMI EX-POST.....	26
24.	DISPOZITA TË RËNDËSISHME QË MUND TË JENË SHKAKTARË TË REFUZIMIT TË APLIKACIONIT.....	26
25.	SHTOJCAT	27
	SHTOJCA 1: LISTA E DOKUMENTEVE TË DORËZUARA.....	27
	SHTOJCA 2: FORMULARI PËR APLIKIM.....	31
	SHTOJCA 3: PROJEKT-PROPOZIM - MODELI	34
	SHTOJCA 4:MODEL PËR PËRGATITJEN E PROJEKT-PROPOZIMIT PËR NËNMASËN 302.5	39
	SHTOJCA 5: MODEL PËR PËRGATITJEN E PLANIT TË BIZNESIT	47
	SHTOJCA 6: FORMULARI I KONTRATËS DHE PROCEDURAT E PROKURIMIT	53
	SHTOJCA 7: LISTA E AKTIVITETE TRADICIONALE ARTIZANLE TË PRANUESHME PËR MBËSHTETJENNË MASËN 302.....	64
	SHTOJCA 8:LISTA E INVESTIMEVE TË PRANUESHME/ SHPENZIMET E PRANUESHME	65
	SHTOJCA 9: LISTA A: LISTA E VENDBANIMEVE NË ZONAT MALORE (“LLOJI A”)	70
	SHTOJCA 10: LISTA B: LISTA E VENDBANIMEVE NË ZONAT MALORE (“LLOJI B”)	75
	SHTOJCA 11: KËRKESA PËR PAGESË PËR MASËN 302	76
	SHTOJCA 12:LETRA INFORMUESE	80
	SHTOJCA 13:FORMA E ANKESËS.....	81

SHTOJCA14: FORMULARI I INDIKATORËVE	83
SHTOJCA 15: LISTA ME ADRESA TË ZYRAVE RAJONALE TË BUJQËSISË	84
SHTOJCA 16: LOGO -PROMOVIMI	84
SHTOJCA 17: LISTA E TRASHIGIMISË KULTURORE PËR MBROJTJE TË PËRKOHSHME.....	85
SHTOJCA 18: KODI I ETIKËS PËRKOMPANITËKËSHILLUESE.....	93

1. OBJEKTIVAT, PRIORITETET DHE MJETET FINANCIARE TË MASËS 302

1.1 Hyrja

Udhëzuesi ka për qëllim t'u ndihmojë aplikuesve në përgatitjen e aplikacioneve të tyre, të qartësojë kushtet e pranueshmërisë që duhet të respektohen, sistemin e pikëve, cilat janë investimet e pranueshme, cilat janë dokumentet e nevojshme për aplikim, si do të bëhet vlerësimi i projekteve, si do të njoftohen aplikuesit për rezultatet e vlerësimit, çka janë procedurat e prokurimit, cilat janë ndëshkimet në rast të parregullsive apo tentimeve për mashtrim etj.

Roli i Udhëzuesit është të sqarojë në detaje dispozitat e paraqitura në masë, dhe jo të përsërisë atë. Prandaj ky nuk e zëvendëson masën por duhet lexuar (bashkë me shtojcat) me qëllim të shmangies së gabimeve gjatë aplikimit.

Udhëzuesi i referohet Masës 302 - "DIVERSIFIKIMI I FERMAVE DHE ZHVILLIMI I BIZNESEVE", pjesë e Programit për Zhvillim Rural i MBPZHR-së. Programi respekton rregullat e IPARD-it të BE-së, për përafrimin e Kosovës me objektivat e BE-së në drejtim të politikave të zhvillimit rural (si pjesë e Politikës së Përbashkët Bujqësore) dhe përgatitjen e Kosovës nga kjo perspektivë për qasje në fondet e ardhshme të BE-së për zhvillimin e zonave rurale të Kosovës.

Kjo masë përbëhet nga këto nën masa:

302.1. - Bletaria - prodhimi, përpunimi dhe marketingu i mjaltit

302.2. - Grumbullimi dhe përpunimi i prodhimeve jodrusore të malit dhe marketingu i tyre¹

302.3. - Përpunimi i prodhimeve bujqësore (të kultivuara) dhe marketingu i tyre²

302.4. - Zhvillimi i aktiviteteve artizanale dhe marketingu i tyre³

302.5. - Zhvillimi i turizmit rural dhe i turizmit në fermë

Secila nënmasë ka alokime të ndryshme financiare, kriteret specifike për pranueshmëri dhe kriteret e veta të përzgjedhjes.

¹ bimët mjekuese dhe aromatike, frutat pyjorë dhe kërpudhat e grumbulluara

² perimet, frutat, erëzat, bimët mjekuese, kërpudhat, qumështi, mushti, vera, rakia nga rrushi dhe nga fruta të tjerë, prodhimi i uthullës, përpunimi i brumërave

³ përpunimi i tekstitit, lëkurës, leshit; përpunimi i drurit; punët e dorës, si përgatitja e kostumeve tradicionale; thurja e veshmbathjeve tradicionale; prodhimi i pëlhurave të thurura dhe të endura; qëndisja / thurja e qilimave dhe sixhadeve; përgatitja e bizhuterive të ndryshme; përpunimi i lëkurave dhe aktiviteteve të tjera që janë punë artizanale

Masa është përgatitur nga personeli i Autoritetit Menaxhues duke u bazuar në studime të pavarura për sektorë, këshillime me palët e interesit dhe përkrahje nga ekspertë ndërkombëtarë.

2. Objektivat e Masës 302

2.1 Objektiva e përgjithshme

Krijimi i vendeve të reja të punës dhe ruajtja e tyre nëpërmjet diversifikimit dhe zhvillimit të aktiviteteve të biznesit në viset rurale me qëllim të pengimit të shpërnguljes së popullatës drejt zonave urbane dhe për një zhvillim të qëndrueshëm të viseve rurale.

2.2 Objektivat Specifike

- Të mbështesë rritjen e të ardhurave të popullatës në vise rurale përmes zhvillimit të aktiviteteve të diversifikimit në fermë dhe jashtë fermës;
- Të mbështesë zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla duke u bazuar në burimet lokale dhe të ndërlidhura me përmirësimin e cilësisë së jetës në zona rurale;
- Të mbështesë ruajtjen dhe zhvillimin e aktiviteteve artizanale tradicionale;
- Të mbështesë zhvillimin dhe promovimin e aktiviteteve dhe shërbimeve të turizmit rural.

Masa 302 “DIVERSIFIKIMI I FERMAVE DHE ZHVILLIMI I BIZNESEVE” synon që të mbështesë nënsektorë të veçantë si: bletarinë, grumbullimin dhe përpunimin e frutave të malit, përpunimin e pemëve, perimeve, qumështit, aktiviteteve tradicionale artizanale si dhe zhvillimin dhe promovimin e aktiviteteve dhe të shërbimeve të turizmit rural.

3. Mjetet financiare për këtë masë

Ndarja indikative buxhetore ndërmjet nënmasave është siç vijon:

Nënmasat	Vlera në €	% e buxhetit
302.1 - Bletaria- prodhimi, përpunimi dhe marketingu i mjaltit;	300,000	20%
302.2 - Grumbullimi dhe përpunimi i prodhimeve jodrusore të malit dhe marketingu i tyre ¹	300,000	20%
302.3 - Përpunimi i prodhimeve bujqësore (të kultivuara) dhe marketingu i tyre ²	300,000	20%
302.4 - Zhvillimi i aktiviteteve artizanale dhe marketingu i tyre ³	300,000	20%
302.5 - Zhvillimi i turizmit rural dhe turizmit në fermë	300,000	20%
Totali	1.500,000	100%

4. Përkufizimet kryesore

- **Shkalla e përkrahjes publike** – është pjesëmarrja (e shprehur në përqindje) e mjeteve publike në shpenzimet e pranueshme
- **Aplikues** – janë personat fizikë apo juridikë që i plotësojnë kriteret e pranueshmërisë të prezantuar në këtë dokument dhe të cilët paraqesin kërkesë për të përfituar nga grantet e zhvillimit rural;
- **Aplikacion** – dorëzimi i të gjitha dokumenteve të kërkuara në Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë;
- **Përfitues** – personi fizik apo juridikështë ai i cili deklarohet si përfitues pas vlerësimit të aplikacionit dhe që ka nënshkruar kontratë me Agjencinë për Zhvillimin e Bujqësisë;
- **Thirrja për aplikim** – njoftimi publik për pranimin e aplikacioneve;
- **Kontrata**– nënkupton kontratën që nënshkruhet mes aplikuesit të përzgjedhur dhe Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë,sipas modelit të parapërgatitur.
- **Shpenzimet apo investimet e pranueshme** – janë shpenzimet apo investimet që përkrahen me mjete publike.
- **Periudha e monitorimit Ex-post** – periudha kohore prej 5 vjetësh pas përfundimit të investimit,gjatë të cilës përfituesi duhet ta ruajë qëllimin e investimit dhe të gjitha kushtet sipas të cilave ai është përzgjedhur dhe ka marrë pikë;
- **Grant** – ndihma financiare e pakthyeshme e dhënë nga Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë për shpenzimet e pranueshme;
- **Autoriteti Menaxhues** – entitet publik brenda MBPZHR-së i organizuar si Departament me përgjegjësi kryesore në hartimin dhe monitorimin e Programit;
- **Masa** – dokument teknik që paraqet njësinë bazë të Programit dhe pjesët kryesore të saj, e qe janë kriteret e pranueshmërisë dhe kriteret e përzgjedhjes së aplikuesve. Masa ka buxhetin e saj përmes të cilit synohet të arrihet ndikim i caktuar. Masa zbatohet përmes thirrjes për aplikim dhe procesit të vlerësimit të projekteve.
- Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë është Agjenci e Pagesave (<http://azhb.rks-gov.net/>) me përgjegjësi kryesore në vlerësimin dhe kontraktimin e projekteve si dhe pagesën e shpenzimeve sipas procedurave të parapara;
- **Programi për Bujqësi dhe Zhvillim Rural 2015** – është dokument teknik i përbërë i cili përcakton masat e zhvillimit rural,logjikën e intervenimit dhe ndikimin e pritur të granteve;
- **Projekt** – investimi i planifikuar i dorëzuar nga aplikuesi;
- **Periudha e implementimit të projektit** – koha prej nënshkrimit të kontratës nga të dyja palët (AZHB dhe përfituesi) deri tek ekzekutimi i pagesës së fundit nga AZHB;
- **Përzgjedhja** – përcaktimi i numrit të pikëve për aplikuesit e pranueshëm,radhitja e tyre në listë sipas pikëve dhe deklarimi i tyre “i përzgjedhur për financim“ dhe shpërndarja e mjeteve financiare duke filluar nga ata në krye të listës.
- **Ndërmarrje mikro** është ndërmarrja që ka të punësuar deri në 9 punëtorë.
- **Ndërmarrje e vogël** është ndërmarrja që ka të punësuar 10 deri në 49 punëtorë.

5. Shkalla e përkrahjes publike dhe aplikuesit e pranueshëm

5.1 Shkalla e përkrahjes

Intensiteti i ndihmës publike është 65% i të gjitha shpenzimeve të pranueshme të investimit.

Kujdes: TVSH është shpenzim i pranueshëm vetëm për persona fizik dhe ndërmarrje joraportuese të TVSH-së. Për ndërmarrjet raportuese të TVSH-së, ky është shpenzim i papranueshëm!

Në këtë adresë të internetit mund të shkarkohen raportet për bizneset me të cilat mund të vërtetohet nëse biznesi është raportues apo jo i TVSH-së:

<http://apps.atk-ks.org/BizPasiveApp/VatRegist/SearchVat>

6. Kriteret e përbashkëta të pranueshmërisë për masën

Kjo masë synon t'i mbështesë ekonomitë e voglafamiljare të cilat duhet t'i plotësojnë kushtet në vijim:

1. Aplikuesi duhet të jetë i regjistruar në Regjistrin e Fermave;
2. Në rast se aplikuesi është person fizik, në kohën e aplikimit ai duhet të jetë mbi 18 vjeç, por jo më i vjetër se 60 vjeç;
3. Aplikuesi është fermer, si person fizik apo juridik sipas Ligjit Nr.03/L-098 Për Bujqësi dhe Zhvillim Rural;
4. Aplikuesit mund të jenë persona juridikë, vetëm nëse janë të regjistruar si ndërmarrje mikro ose të vogla sipas Ligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e ligjit 02/1-5 Për Mbështetjen e Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme
 - a) mikro-ndërmarrja duhet të ketë të punësuar deri nëntë (9) punëtorë;
 - b) ndërmarrja e vogël duhet të ketë të punësuar prej dhjetë (10) deri dyzet nëntë (49) punëtorë;
5. Aplikuesi investimin duhet ta kryejë në zona rurale (sipas definicionit të MBPZHR-së);
6. Aplikuesi duhet ta ketë të kryer së paku shkollën e mesme; në rast të personave juridikë menaxheri;
7. Nëse aplikuesi nuk ka të kryer shkollën e mesme, duhet të bëjë një deklaratë me shkrim ku zotohen që do të vijojnë një kurs trajnimi me kohëzgjatje prej së paku 20 orësh, para aplikimit për pagesën përfundimtare.
8. Aplikuesi duhet ta dorëzojë aplikacionin me të gjitha dokumentet e paraqitura në listën e dokumenteve të kërkuara që është paraqitur si shtojcë e këtij udhëzuesi;
9. Aplikuesi duhet t'i ketë të rregulluara detyrimet tatimore dhe atë, personat fizikë tatimin në pronë kurse personat juridikë, tatimin në fitim dhe nuk guxojnë të kenë obligime financiare (borxhe) ndaj MBPZHR-së;

10. Të gjithë përfituesit e projekteve të zhvillimit rural duhet t'i mirëmbajnë investimet e tyre gjatë pesë vjetëve pas implementimit të investimit, aq sa zgjat periodha monitoruese;
11. Aplikuesi për projektet investuese në të cilat investimet e pranueshme janë më të vogla ose baras me 20,000 €, duhet të dorëzojnë një projekt-propozim sipas modelit të MBPZHR-së. Projekt-propozimi;
12. Aplikuesi që aplikon për nënmasën 302.5 -Zhvillimi i turizmit rural dhe turizmit në fermë, duhet ta dorëzojnë projekt-propozimin e veçantë për këtë nënmasë;
13. Aplikuesi për projektet investuese në të cilat investimet e pranueshme janë më të mëdha se 20,000 €, duhet ta dorëzojnë një plan të biznesit sipas modelit të MBPZHR-së. Plani i biznesit për nënmasën e turizmit rural është i veçantë;
14. Modeli për projekt-propozim teknik dhe për planin e biznesit do të publikohet në uebfaqen e Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë dhe do të jetë në dispozicion për të gjithë përfituesit;
15. Të gjithë përfituesit të cilët në planin e tyre të biznesit kanë deklaruar se do të krijojnë vende të reja të punës dhe për këtë kanë fituar pikë gjatë vlerësimit, duhet t'i krijojnë ato dhe t'i dëshmojnë me pagesën e kontributit pensional dhe tatimit në paga për së paku muajin e fundit para kërkesës për pagesën e fundit. Përfituesit janë të detyruar t'i mbajnë këto vende pune të plotësuara me punëtorë me orar të plotë për 5 vjet, aq sa zgjat periodha monitoruese;
16. Investimet e financuara nga kjo skemë e granteve nuk bën të jenë të financuara edhe nga zyra e BE-së apo ndonjë donator tjetër publik. Në rast të zbulimit se përfituesi ka tentuar të përfitojë përkrahje nga dy burime publike, atij nuk i jepet përkrahja ose nëse e ka marrë atë, ai do të detyrohet t'i kthejë mjetet e marra si dhe do të zbatohen ndëshkimet në përputhje me ligjin;
17. Përfituesit nuk mund t'i jepet një projekt i ri nëse projektet e mëparshme nuk janë përfunduar në mënyrë të rregullt;
18. Aplikuesi duhet të dëshmojë që është pronar i tokës / ngastrësne të cilën bëhet investimose që ka kontratë qiraje për së paku 5 vjet në rast të investimeve, që nuk nënkuptojnë punë ndërtimore;
19. Aplikuesi në rast të investimeve në punë ndërtimore, duhet të dëshmojë të drejtë e shfrytëzimit të ndërtesave/tokës/parcelës për së paku 10 vjet apo të dëshmojë pronësinë ose të drejtën e shfrytëzimit për qëllime ndërtimi për së paku 10 vjet;
20. Aplikuesi në rast të projekteve të ndërtimit/rinovimit/zgjerimit duhet t'i dorëzojë kopjet e skicave teknike dhe vlerësimin e shpenzimeve për punët dhe materialet parapara (me rastin e aplikimit);
 - **Në momentin e aplikimit duhet të dorëzohen edhe këto dokumente:**
 - a) Kopjen e skicave dhe vlerësimin shpenzimeve për materiale dhe punë;
 - b) Kopjen e planit të parcelës ku do bëhet investimi;
 - c) Pëlqimin nga komuniteti; (nëse parashihet me Ligj)
 - d) Fletën poseduese ose kontratën e noterizuar të qirasë për së paku 10 vjet për parcelën ose objektin ku do të bëhet ndërtim/rindërtim/zgjerim, kurse për projekte që nuk parashohin ndërtim/rinovim/zgjerim në pronë të huaj mjafton kontrata e qiramarrjes për 5 vjet;

- Kurse,para kërkesës për pagesë në Agjencinë për Zhvillimin e Bujqësisë,duhet tëdorëzojnë:

- a) Lejen ndërtimorenga Komuna,në rast të ndërtimeve që janë mbi 10m²;
- b) Vlerësimin e ndikimit në mjedis nëse është e obligueshme sipas ligjit;
- c) Përfituesit nga nënmasa 302.5, të cilët investojnë në objekte që janë në Listën e Trashëgimisë Kulturore, pas nënshkrimit të kontratës me Agjencinë për Zhvillimin e Bujqësisë, por para fillimit të investimeve, duhet ta marrin pëlqimin nga Ministria e Kulturës/Departamenti i Trashëgimisë Kulturore

Të gjithë aplikuesit duhet të kalojnë kontrollin e pranueshmërisë. Nëse konstatohet se është i papranueshëm,aplikacionirefuzohet. Pranueshmëria e aplikuesit bëhet në bazë të dokumenteve të kërkuara për aplikim dhe atyre të dorëzuara – shih shtojcën 1.

Pasi kontrollohet për pranueshmërinë e aplikuesve,do të vazhdohet me kontrollin e pranueshmërisë së aplikacionit. Aplikacionet e refuzuara nuk do të marrin pikë (rezultat).

Kujdes: të gjitha investimet e pranueshmërisë duhet të mirëmbahen të paktën edhe 5 vjet pas zbatimit të projektit. Mosrespektimi i këtyre kushteve do të thotë kthimin e grantit të pranuar, plus ndëshkimet shtesë!

Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë do të bëjë kontrole periodike dhe sistematike në këtë drejtim.

Aplikuesit duhet t'i plotësojnë edhekëto kushte të pranueshmërisë:

- Aplikuesit duhet të jenë fermerë sipas Ligjit për Bujqësi dhe Zhvillimi Rural (Nr. 03/L-098) dhe ndërmarrjet tjera bujqësore të regjistruara në Regjistrin e Fermës;
- Regjistrimi në Regjistrin e Fermës bëhet te zyrtarët për bujqësi në kuvende komunale;
- Aplikuesit janë të obliguar të kenë të rifreskuar të dhënat nëRegjistrin e Fermës me regjistrim të plotë të të gjitha kapaciteteve prodhuese;
- Përfituesit përfundimtarë,para kërkesës për pagesën e fundit janë të obliguar të deklarojnë çdo ndryshim të kapaciteteve të tyre prodhuese si rezultat i investimit nëRegjistrin e Fermës;
- Është e rëndësishme që të dhënat/informacionet e paraqitura në Regjistrin e Fermës të jenë të ndërlidhura me të dhënat/informacionet e dhëna në projekt-propozim. Çdo mospërputhje mund të çojë në vonesa në vlerësim për shkak të kërkesës për sqarime,ose përjashtim të aplikacionit.

Kujdes: në rast se aplikuesi është femër, ajo duhet të jetë e regjistruar në regjistrin e Fermës - Jo burri i saj, dhe anasjelltas

Kujdes: është e rëndësishme që të paguhen taksat gjatë zbatimit të projektit si dhe gjatë periudhës së monitorimit (5 vjet pas zbatimit të projektit). Përfituesit për të cilët vërtetohet se kanë taksë të papaguara gjatë afatit të përmendur, do të jenë të detyruar që të paguajnë të gjithë grantin e pranuar, plus ndëshkimet.

- Aplikuesi duhet të paraqesë një projekt-propozim/plan biznesi ose projekt-propozim për nënmasën 302.5 sipas modelit të kërkuar - shih shtojca 3,4 dhe 5
- Vlera e investimit duhet të jetë së pak 5000€.
- Formulari i treguesve duhet të plotësohet me përgjegjësi –shih shtojcën 14

Kujdes: Vendet e reja të punës të deklaruara duhet të regjistrohen dhe taksat e tyre duhen paguar, sipas legjislacionit kombëtar, deri në fund të periudhës 5-vjeçare të monitorimit.

7. Kriteret specifike të pranueshmërisë

302.1: Bletaria prodhimi/përpunimi dhe marketingu i mjaltit

Aplikuesit duhet:

- Të kenë së paku 30 koshere;
- Të dëshmojnë përvojë të mjaftueshme bujqësore. Përvojë e mjaftueshme bujqësore konsiderohet: Fakulteti i Bujqësisë, Shkolla e Mesme Bujqësore ose dëshmi për përvojë dyvjeçare në bletari.
- Aplikuesit që nuk kanë përvojën e cekur sipër, japin një deklaratë me shkrim ku zotohen që do të vijojnë një kurs trajnimi me kohëzgjatje prej së paku 20 orë mësimore të cilat do t'i përfundojnë para aplikimit për pagesë.

302.2 - Grumbullimi dhe përpunimi i prodhimeve jodrusore të malit dhe marketingu i tyre

Aplikuesit duhet të jenë:

- Personat juridikë dhe fizik;
- Të licencuar nga Departamenti i Pylltarisë i MBPZHR-së për grumbullimin e bimëve mjekuese dhe aromatike, frutave pyjore dhe kërpudhave. Ky kriter nuk vlen për aplikuesit që aplikojnë për t'u pajisur me tharëse të prodhimeve jodrusore të malit.

302.3 - Përpunimi i prodhimeve bujqësore të (kultivuara) dhe marketingu

Aplikuesit duhet:

- Të posedojnë më pak se 4 hektarë vreshta, nëse aplikon për prodhimin e verës dhe rakisë së rrushit;
- Që kapacitetet e tyre përpunuese nuk tejkalojnë 500 litra në ditë nëse aplikojnë për përpunimin të qumështit.

302.4 - Zhvillimi i aktiviteteve artizanale dhe marketingu i tyre

Aplikuesi:

- Nuk ka kriteret e veqanta

302.5 - Zhvillimi i turizmit rural dhe turizmit në fermë

Aplikuesi:

- Duhet të dëshmojëse objekti që do të rinovohet/adaptohet/zgjerohet duhet t'i përshatet stilit përkatës (tradicional) të zonës rurale dhe të mbështetet me fotografi për ekzistimin e atij objekti me konstrukt tradicional (në kohën e aplikimit);

- Përfituesitë cilët investojnë në objekte që janë në Listën e Trashëgimisë Kulturore, pas nënshkrimit të kontratës me Agjencinë për Zhvillimin e Bujqësisë, por para fillimit të investimeve, duhet tamarrin pëlqimin nga Ministria e Kulturës/Departamenti i Trashëgimisë Kulturore;
- Përfituesi, pas nënshkrimit të kontratës me AZHB-në, duhet ta sjellë projektin e dizajnuar nga arkitekti të përshtatur pamjes së objektit siç është paraqitur në fotografi në kohën e aplikimit;
- Në rast të projekteve me bujtinë, në fund të investimit objekti nuk duhet të ketë më pak se 5 shtretër dhe jo më shumë se 15 shtretër;
- Në rast të investimeve në ndërtimin e shtigjeve për këmbësorë dhe biçiklistë përreth objekteve të turizmit rural, (me rastin e aplikimit duhet të sillen pëlqimi i pronarëve të pronave nëpër të cilat kalon ky shteg i noterizuar nga notari);
- Zotim që në fund të investimit (para kërkesës për pagesë) përfituesi do ta regjistrojë aktivitetin e tij ekonomik (biznesin) në ARBK dhe se do ta punësojë së paku vetveten dhe këtë ta dëshmojë me pagesën e tatimeve dhe kontributeve në të ardhura së paku për një muaj.

8. Kriteret e përzgjedhjes dhe sistemi i pikëve

Kriteret e përzgjedhjes janë të dizajnuara që të mbështesin arritjen e objektivave të masës.

Si rregull e përgjithshme, sistemi i pikëve zbatohet vetëm te projektet e pranueshme.

Me qëllim të arritjes së synimit të sektorit të bujqësisë nevojat dhe mundësitë, secila nënmasë ka kriteret e veta të përzgjedhjes.

302.1 Bletaria, prodhimi/përpunimi dhe marketingu i mjaltit

Nr	Lloji i kriterëve	Kriteri/Kategoria	Pik	
1.	Madhësia e fermës në momentin e aplikimit	Nr. i koshereve	30-100	30
			101-300	20
			>300	15
2.	Përvoja në bletari dhe prodhim të mjaltit	Vlera e prodhimit të dy viteve të fundit: 1000 – 3000€	20	
		> 3000 €	15	
3.	Sigurimi i punësimit në viset rurale (krijimi i vendeve të punës matet me njësiekuivalenteve me orar të plotë - POP)	Krijimi i mbi një POP ⁴ (në bazë të projekt propozimit teknik)	10	
4.	Vendndodhja e fermës/biznesit	Ndodhet në zonë malore	10	
		Ndodhet në zona rurale	8	
5.	Përkrahje për herë të parë	Aplikuesi nuk ka qenë përfitues i granteve të MBPZHR -së në dy vitet e fundit	10	
6.	Aspekti gjinor	Investimi udhëhiqet nga gratë ndërmarrëse	2	
7.	Përgatitja shkollore	Fakulteti i Bujqësisë	8	
		Shkolla e Mesme e Bujqësisë	5	
8.	Përmirësimi i strukturës së moshës në viset rurale	Ndërmarrësit e rinj nën 40 vjeç	5	
9.	Bujqësia organike e zhvilluar	Certifikuar për prodhim organik	3	
10.	Të jetë anëtar i shoqatës së bletarëve	Certifikata e anëtarësisë	2	
Gjithsej			100	

⁴ POP – të punësuar me orar të plotë

302.2 Grumbullimi dhe përpunimi i prodhimeve jodrusore të malit dhe marketingu i tyre

Nr	Lloji i kriterëve	Kriteri/Kategoria	Pikët
1.	Përvoja në aktivitetin e grumbullimit	Vlera e prodhimit të dy viteve të fundit	25
		0 -1000 €	
		1000 - 3000 €	30
		> 3000 €	35
2.	Sigurimi i punësimit në viset rurale (krijimi i vendeve të punës matet me njësi të ekuivalenteve me orar të plotë - POP)	Krijimi më shumë se një POP (në bazë të projekt propozimit teknik)	10
3.	Vendndodhja e biznesit	Ndodhet në zonë malore	15
		Ndodhet në zona rurale	10
4.	Përkrahje për herë të parë	Aplikuesi nuk ka qenë përfitues i granteve të MBPZHR në dy vitet e fundit	10
5.	Aspekti gjinor	Investimi udhëhiqet nga gratë ndërmarrëse	2
6.	Përgatitja shkollore	Fakulteti i bujqësisë / pylltarisë	8
		Shkolla e mesme e bujqësisë/pylltarisë	5
7.	Përmirësimi i strukturës së moshës në viset rurale	Ndërmarrësit e rinj deri në 40 vjeç	10
8.	Bujqësia organike e zhvilluar	Certifikuar për prodhim organik	10
Gjithsej			100

302.3Përpunimi i prodhimeve bujqësore (të kultivuara)dhe marketingu i tyre

Nr	Lloji i kritereve	Kriteri/Kategoria	Pikët
1.	Diversifikimi i aktivitetit në fermë (përshkrimi në projekt-propozim ose plan biznesi)	Investimi synon që ta diversifikojë aktivitetin në fermë /përveç aktivitetebujqësor merret edhe me ndonjë aktivitet tjetër përpunues (Aplikuesi lëndën e parë për përpunim e prodhon në fermën e tij)	30
2.	Përvoja e ekonomisë familjare /biznesit në aktivitetet e përpunimit (e paraqitur në projekt - propozimdeklarata ose pasqyra e të ardhurave për persona juridikë /për vitin paraprak më së paku për një vit)	Kanë përvojësë paku njëvjeçarenënjë nga përpunimet e listuara ⁵	20
		Nuk kanë përvojë në përpunimete listuara	15
3.	Sigurimi i punësimit në viset rurale (krijimi i vendeve të punës matet me njësi të ekuivalenteve me orar të plotë - POP) e paraqitur në një projekt-propozim	Krijimi isë pakunjë vendi të ri të punës POP	10
4.	Vendndodhjae investimit	Ndodhet në zonë malore	10
		Ndodhet në zonë rurale	8
5.	Përgatitja shkollore	Fakulteti i Bujqësisë	10
		Shkolla e Mesme e Bujqësisë	8
6.	Aspekti gjinor	Investimi udhëhiqet nga gratë ndërmarrëse	10
		Investimi udhëhiqet nga meshkujt ndërmarrës	8
7.	Përmirësimi i strukturës së moshës në viset rurale	Ndërmarrësit e rinj deri në40 vjeç	10
Gjithsej			100

⁵ (perime, fruta, erëza, bimë mjekuese, kërpudha, qumësht, musht, vera, raki nga rrushi dhe fruta të tjera, prodhimi i uthullës dhe përpunimi i brumërave)

302.4 -Zhvillimi i aktiviteteve artizanale dhe marketingu i tyre

Nr	Lloji i kriterëve	Kriteri/Kategoria	Pikë
1.	Aspekti gjinor	Investimi udhëhiqet nga gratë ndërmarrëse	25
		Investimi udhëhiqet nga meshkujt ndërmarrës	15
2.	Përmirësimi i strukturës së moshës në viset rurale	Ndërmarrësitderi në 40 vjeç	15
		Ndërmarrësitmbi 40 vjeç	10
3.	Madhësia e familjes/Certifikata e bashkësisë familjare	Mbi 8 anëtarë	15
		6 deri 8 anëtarë	10
		Deri5 anëtarë	5
4.	Vendndodhja e investimitfermës/biznesit	Ndodhet në zona malore	15
		Ndodhet në zona rurale	10
5.	Sigurimi i punësimit në viset rurale (krijimi i vendeve të punës matet me njësi të ekuivalente me orar të plotë – POP	Krijimi injë venditë punësPOP	10
6.	Përvoja e ekonomisë familjare/biznesitnë aktivitetet e përpunimit (paraqitet në projekt-propozim sideklaratë për persona fizik ose pasqyra e të ardhurave për persona juridik për vitin paraprak	Kanë përvojënë ofrimin e ndonjërit nga artizanalet e listuara ⁶	10
		Nuk kanë përvojënë ofrimin e shërbimeve të listuara	5
7.	Përgatitja shkollore	Fakulteti	10
		Shkolla mesme	8
Gjithsej			100

*Personat juridikë e dëshmojnë me përvojën me pasqyrën e të ardhurave për vitin paraprak kurse aplikuesit si persona fizikë e përshkruajnë përvojën e tyre në projekt-propozim ose plan biznesi.

302.5 - Zhvillimi i turizmit rural dhe turizmi në fermë

Nr	Lloji i kritereve	Kriteri/Kategoria	Pikë
1.	Lloji i turizmit (të paraqitet në projekt-propozim ose në plan biznesi)	Aplikuesi ka edhe fermë	20
		Aplikuesi nuk ka fermë	15
2.	Vendi i investimit	Investimi në zona malore	10
		Investimi në zona rurale	5
3.	Lloj i investimeve: Nëse investohet në më shumë se një kriter,pikët merren nga kriteri për të cilin janë investuar më shumë para)	Investimet në bujtina (më së paku 5 shtretër të rinj)	20
		Investimet në ofrimin e shërbimeve gastronomike	15
		Investimet në shtigje për ecje dhe biçikleta	10
4.	Përmirësimi i strukturës së moshës së ndërmarrësvenë viset rurale	Ndërmarrësit e rinj deri në40 vjeç	10
5.	Aspekti gjinor	Investimi udhëhiqet nga gratë ndërmarrëse	5
		Investimi udhëhiqet nga meshkujt ndërmarrës	3
6.	Sigurimi i punësimit në viset rurale (krijimi i vendeve të punës matet me njësi të ekuivalenteve me orar të plotë - POP)	Krijimi injë venditë punësPOP	5
7.	Përvojat aplikuesit ne turisëm rural	Kanë përvojënë ofrimin e ndonjërit nga shërbimet e listuara	5
		Nuk kanë përvojë në ofrimin e shërbimeve të listuara	3
8.	Rinovimi i ndonjë objekti tradicional	Është në listën e trashëgimisë kulturore	10
		Nuk është në listën e trashëgimisë kulturore	5
9.	Përgatitja shkollore	Fakulteti	5
		Shkolla e mesme	3
10.	Aplikuesit janë të rekomanduar nga GLV-të	Projekti është rekomanduar ngaGLV me styrategji te miratuar	10
		Projekte që nuk kanë rekomandimin nga GLV-të	8
Gjithsej			100

VËREJTJE PER TË GJITHA NËNMASAT:

Në rastet kur aplikuesit kanë numër të njëjtë të pikëve,perparësi kanë projektet e dorëzuara më herët

Sqarime për disa nga kriteret e përzgjedhjes

Kriteri **“Sigurimi i punësimit në viset rurale”** - nënkupton se pas zbatimit të projektit do ta punësojë veten ose do të krijojë një vend të ri pune. Të gjithë përfituesit të cilët në projekt-propozimin ose në planin e tyre të biznesit kanë deklaruar se do të krijojnë vende të reja të punës dhe për këtë kanë fituar pikë gjatë vlerësimit, duhet t'i krijojnë ato dhe t'i dëshmojnë me pagesën e kontributit pensional dhe tatimit në paga për së paku muajin e fundit para kërkesës për pagesën e fundit. Përfituesit janë të detyruar t'i mbajnë këto vende pune të plotësuara me punëtorë me orar të plotë për 5 vjet, aq sa zgjat periudha monitoruese.

Personat fizikë, nëse duan t'i marrin pikët e këtij kriteri, duhet që 10 ditë pas nënshkrimit të kontratës me AZHB-në, t'i regjistrojnë ndërmarrjet e tyre. Regjistrimin e ndërmarrjes dhe punësimin aplikuesi duhet t'i paraqesë në projekt-propozim ose te plani i biznesit, ashtu që gjatë vlerësimit të jepen pikët për këtë.

Kriteri **“Përvoja në aktivitetet”** - Vërtetimi i qarkullimit të mjeteve financiare (shitja në €) gjatë dy viteve të fundit.

- Për biznese të regjistruara (pasqyra financiare dhe bilanci i gjendjes)
- Për personat fizikë, certifikatën nga regjistri ifermës të bashkangjitur me aneksin ku tregohet se sa është numri i koshereve:
- Nëse numri i koshereve është 30 - 150, vlerësohet të ketë pasur qarkullim vjetor prej 1000 - 3000 €.
- Nëse numri i koshereve është mbi 150, vlerësohet të ketë pasur qarkullim vjetor mbi 3000 €

Kriteri **“Përmirësimi i strukturës së moshës në viset rurale”** në rastet kur aplikuesi është personi juridik, për dhënien e pikëve për fermerë të rinj, do të merret në konsideratë mosha e pronarit të ndërmarrjes, kurse në rast kur personi juridik ka ma shumë pronarë, atëherë merret për bazë mosha mesatare e të gjithë bashkëpronarëve.

Kriteri: **“Ferma/aktiviteti ndodhet në zonë malore”** pikët për këtë kriter të përzgjedhjes i marrin ata aplikues të cilët e bëjnë investimin në Zona Malore të cilat janë të paraqitura në Shtojcën nr.9 dhe 10. Kriteri: **Investimi synon që tashtojë aktivitetin në fermë /përveç aktiviteve bujqësor merret edhe me ndonjë aktivitet tjetër përpunues te nënmasa 302.3.** Përpunimi i prodhimeve bujqësore (të kultivuara) dhe marketingu i tyre nënkupton se aplikuesi në ekonominë e tij familjare ka fermë bujqësore dhe prodhon prodhime bujqësore.

AFATI I ZBATIMIT TE PROJEKTEVE

Afati i implementimit të projekteve të kësaj mase është 120 ditë nga dita e nënshkrimit të kontratës me AZHB-në. Pas periudhës prej 120 ditësh, përfituesi ka edhe 15 ditë shtesë për përgatitjen e dokumentacionit dhe paraqitjen e kërkesës për pagesë. AZHB mund të zgjasë afatin e implementimit për më së shumti 30 ditë, nëse ka arsye të forta për këtë, siç është sjellja e ndonjë makinerie specifike prej ndonjë vendi të huaj, etj.

9. Rregullat e shpenzimeve të pranueshme

Shpenzimet e pranueshmeindikative për këtë masë:

Paratë e grantit mund të merren vetëm pasi përfituesi ka realizuar investimin dhe ka paguar faturat në përputhje me aplikacionin e tij dhe kontratën të cilën e ka nënshkruar me Agjencinë për Zhvillimin e Bujqësisë (shih shtojcën nr.6).

Shpenzimet janë të pranueshme vetëm nëse ato ndodhin pas nënshkrimit të kontratës mes aplikuesit dhe Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë me përjashtim të shpenzimeve administrative për përgatitjen e projektit të cilat mund të ndodhin para nënshkrimit të kontratës, por ato u pranohen vetëm aplikuesve të përzgjedhur.

Të gjitha mallrat e blera duhet të jenë pjesë e listës së shpenzimeve të pranueshme (shih shtojcën nr. 8)

Shpenzimet e pranueshme duhet të përkufizohen në:

- Ndërtimi/rinovimi/zgjerim të pronës së palujatshme (po jo edhe blerja e pronës);
- Blerja e makinave, pajisjeve sipas vlerës së tregut;
- Shpenzimet administrative (përgatitja e projekt-propozimit) nuk mund ta tejkalojnë vlerën prej 3% të shpenzimeve të pranueshme;
- Shpenzimet maksimale të pranueshme për marketingun nuk mund të kalojnë 10% të vlerës së gjithëmbarshme të pranueshme të projektit. Investimet për marketingun e produkteve të prodhuara dhe përpunuara janë: materialet promovuese, pagesat për pjesëmarrje në panairët lokale/kombëtare;
- Në rast të investimeve që parashohin ndërtim/rinovim të objekteve, shpenzimet për arkitektë dhe inxhinierë janë të pranueshme deri në vlerën 7% të shpenzimeve të pranueshme;

10. Niveli i përkrahjes

Shpenzimet minimale të pranueshme për projekte në kuadër të kësaj mase do të jenë të kufizuara në:

- Për nënmasën 302.1, 302.2, 302.3 dhe 302.4 dhe 302.5 në: **5000 EUR**

Shpenzimet maksimale të pranueshme për projekte në kuadër të kësaj mase do të jenë të kufizuara në:

- Për nënmasën 302.1, 302.2, 302.3 dhe 302.4 deri **30 000 EUR** ndërsa për masën 302.5 deri në **50,000 EUR**

Shpenzimet e pranueshme indikative për nënmasën 302.1:	Investimet në koshere, në prodhim të mjaltit, në makineri dhe pajisje për përpunim;
	Rimorkiot e specializuara për bartjen e koshereve vetëm ata mbi 50 koshere;
	Investimet në pajisje për nxjerrjen e qumështit të bletës;
	Investimet në pajisje për kultivimin e mëmave;
	Ndërtimi/rinovim dhe pajimi i objekteve për ruajtje dhe përpunim;
	Blerja e pajisjeve për mjaltë dhe laboratorëve për analizim të produkteve të bletëve;
	Blerja e linjave teknologjike për përpunim të mjaltit dhe paketim;
	Themelimi dhe pajisja e stacioneve për mbarështim;
	Blerja e pajisjeve tjera relevante;
	Investimet për tregtimin e produkteve të prodhuara dhe përpunuara (materialet promovuese, pagesat për pjesëmarrje në panairët lokale/kombëtare, për nisma të prodhuesve

11. Lista e shpenzimeve indikative për nënmasa është si në vijim

- Shpenzimet maksimale të pranueshme për marketingnuk mund të kalojnë 10% të vlerës së gjithëmbarshme të projektit.

Investimet e pranueshme indikative për nënmasën 302.2	Ndërtimi/rinovimi i objekteve për ruajtjen, përpunimin dhe paketimin e bimëve mjekuese, frutave pyjore dhe kërpudhave të grumbulluara;
	Blerja e pajisjeve për: larje, pastrim, ruajtje, klasifikim dhe përpunim;
	Blerja e pajisjeve për, ngrirje të thellë, për tharje etj;
	Blerja e rafteve për terje;
	Pajisje për, matje (peshore) paketim dhe etiketim;
	Investimet për tregtimin e produkteve të prodhuara dhe përpunuara (materialet promovuese, pagesat për pjesëmarrje në panairët lokale/kombëtare. për nisma të prodhuesve):

- Shpenzimet maksimale të pranueshme për marketing nuk mund të kalojnë 10% të vlerës së gjithëmbarshme të projektit

Investimet e pranueshme indikative për nënmasën 302.3

Ndërtimi / rinovimi i objekteve për prodhim, përpunim dhe ruajtje të prodhimeve;

Ndërtim i objektit / rinovimi i objekti me enterier tradicional për përdorim si pika shitëse për prodhimet lokale;

Investimet në makina dhe pajisje përpunuese për pastrim, klasifikim, tharje, grumbullim, ruajtje (frigoriferë me ftohje, me ngrirje, furra për pjekje të brumërave, përzirse të ndryshme të brumërave, pajisje për prodhimin e rakisë, pajisje për mbushje për raki dhe verera);

Pajisje për matje, paketim dhe etiketim;

Investimet në pajisjet specifike për përpunim me theks në përmirësimin e sigurisë dhe cilësisë së ushqimit;

Investimet për tregtimin e produkteve të prodhuara dhe përpunuara (materialet promovuese, pagesat për pjesëmarrje në panairët lokale/kombëtare, për nisma të prodhuesve)

- Shpenzimet maksimale të pranueshme për marketing nuk mund të kalojnë 10% të vlerës së gjithëmbarshme të projektit

Investimet e pranueshme indikative për nënmasën 302.4

Ndërtimi/ rinovimi i objekteve për zhvillimin e aktiviteteve artizanale dhe ruajtjen e prodhimeve;

Ndërtim i objektit / rinovimi i objektit me enterier tradicional për përdorim si pika shitëse për prodhimet lokale;

Investimet në blerjen e pajisjeve për thurje dhe për endje të pëlhurave;

Investimet në blerjen e pajisjeve për punimin qilimave dhe sixhadeve;

Investimet në blerjen e pajisjeve për përpunimin e lëkurës;

Investimet në blerjen e pajisjeve për përpunimin e drurit dhe aktiviteteve tjera artizanle që janë punë dore;

Investimet në blerjen e pajisjeve për aktivitete të tjera artizanle;

Investimet për tregtimin e produkteve të prodhuara dhe përpunuara (materialet promovuese, pagesat për pjesëmarrje në panairët lokale/kombëtare, për nisma të prodhuesve)

- Shpenzimet maksimale të pranueshme për marketing nuk mund të kalojnë 10% të vlerës së gjithëmbarshme të projektit

Investimet e pranueshme indikative për nënmasën 302.5

Rinovimi/adaptimi/zgjerimi i objekteve tradicionale si bujtina dhe për ofrimin e shërbimeve gastronomike; (jo më pak se 5 vende për fjetje dhe jo më shumë se 15 vende për fjetje);

Rinovimi i objekteve me pamje tradicionale (mulli etj.) për përdorim si pika shitëse për prodhimet lokale, për ofrimin e shërbimeve gastronomike tradicionale, për ofrimin e informatave për atë zone rurale;

Investime në ndërtimin e shtigjeve për këmbësorë dhe biciklista përreth objekteve të turizimit rural;

Blerja e pajisjeve që nevojiten për regullimin/mobilimin e dhomave, kuzhinës, salla ku ofrohet ushqimi (shtreter, ulëse, tavolina, karrige etj.)

Blerja e pajisjeve që ofronjë aktivitete për argëtim të fëmijëve (tobagan, luhatëse, tavolinë tenisi etj.)

Investimet në krijimin e uebfaqes

- Shpenzimet maksimale të pranueshme për marketing nuk mund të kalojnë 10% të vlerës së gjithëmbarshme të projektit

12. Promovimi i përkrahjes

Të gjithë përfituesit duhet t'i respektojnë rregullat e promovimit të përcaktuara nga institucioni financues. Të gjithë përfituesit e granteve nga Programi për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, para kërkesës për pagesën e fundit, në vendin e investimit, duhet të vendosin një tabelë siç është paraqitur në shtojcën nr.16. Kjo tabelë duhet të vendoset në vend të dukshëm, me madhësi: 100cm x 50 cm, e punuar nga plastikë e fortë, e shkruar me ngjyrë të qëndrueshme ndaj ndikimeve atmosferike.

13. Shpenzimet e papranueshme

Shpenzimet e papranueshme janë obligim i përfituesit, dhe nuk duhet të përfshihen në kërkesën për pagesë. Përfituesi duhet të ketë burimet e veta financiare për t'i mbuluar plotësisht këto kosto!

Për shpenzimet e papranueshme nuk ka nevojë që të respektohen procedurat e prokurimit.

Shpenzimet e mëposhtme nuk janë të pranueshme:

1. Shpenzimet e bëra para nënshkrimit të kontratës me AZHB-në, përveç shpenzimeve administrative;
2. Tatimet, përfshirë TVSH-në, përpos për persona fizikë dhe ndërmarrje joraportuese të TVSH-së. Taksat doganore dhe të importit dhe ndalesat e tjera;
3. Blerja, marrja me qira ose lizingu i tokës dhe ndërtesave ekzistuese;
4. Gjokat, ndëshkimet financiare dhe shpenzimet e gjyqit;

5. Shpenzimet operative (shpenzimet për zhvillimin e aktivitetit;)
6. Pajisjet e përdorura (të dorës së dytë);
7. Ndalesat e bankës,shpenzimet e garantimit dhe ndalesat e ngjashme;
8. Shpenzimet e konvertimit,taksat dhe humbjet nga këmbimi shoqëruar me cilëndo llogari specifike në € për komponent,si dhe shpenzimet tjera të pastra financiare;
9. Kontributet në natyrë;
10. Blerja e të drejtave për prodhim bujqësor,kafshëve,bimë njëvjeçare dhe mbjellja e tyre;
11. Çfarëdoshpensimi i mirëmbajtjes,zhvlerësimit dhe qirasë;
12. Çfarëdo shpensimi ibërë nga administrata publike për menaxhimin dhe zbatimin e asistencës;
13. Shpenzimet e sigurimit.

Shpenzimet e financuara në kuadër të granteve nuk duhet të jenë subjekt i ndonjë financimi tjetër publik,i BE-së ose ndonjë donator tjetër.

14. Procedurat e aplikimit

Përmbajtja e aplikacionit

KUJDES: Në mënyrë që të pranohet aplikacioni i përgatitur duhet ta respektojë rendin/numrin e dokumenteve si janë më poshtë të paraqitura! Gjithashtu, të gjitha dokumentet duhet të përfshihen në një dosje. Shih shtojcën nr. 1

Në rast se kërkohen kopje të dokumenteve, në momentin e dorëzimit, të gjitha origjinalet duhet të paraqiten/prezantohen zyrtarit të Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë. Përveç kësaj, parashtruesi duhet të shkruajë në kopje tekstin e mëposhtëm: "*Si origjinali*", dhe duhet ta nënshkruajë.

Aplikacioni duhet të dorëzohet në Zyrat Rajonale të Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë, shih adresën e tyre në shtojcën nr.15

15. Dorëzimi i aplikacioneve dhe afati i fundit

Kur?

Thirrja për Aplikim bëhet nga Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë dhe njoftimi do të publikohet në faqen e internetit të MBPZHR-së: <http://ëëë.mbpzhr-ks.net/> dhe në faqen e internetit të Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë <http://azhb.rks-gov./>.

AZHB-ja planifikon që ta shpallë thirrjen për Aplikim në tremujorin e parë të vitit. Ftohen të interesuarit që ta vizitojnë uebfaqen e AZHB-së së paku njëherë në javë. Aplikacionet së bashku me të gjitha dokumentet e kërkuara -(shih Shtojca nr.1) duhet të dorëzohen vetëm brenda periudhës së përmendur në kuadër të shpalljes.

Në rast të mungesës së ndonjë dokumenti obligativ, zyrtari i AZHB-së nuk e pranon aplikacionin. Aplikuesi ka afat deri në përfundim të thirrjes për aplikim që t'i kompletojë dokumentet.

Ku?

Aplikacionet duhet të dorëzohen në Zyrat Rajonale të Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë, në adresën e tyre të shënuar në kuadër të Shtojcës nr.15

16. Procedura e përzgjedhjes, vlerësimi dhe përzgjedhja e aplikacioneve

Vlerësimi i projekt-propozimit

Plani i Biznesit ose Projekt-Propozimi janë pjesë e verifikueshmërisë së pranueshmërisë.

Kujdes: Të dhëna të rreme/false do të çojnë në refuzimin e aplikacionit ose kthimin e çdo pagese të bërë për përfituesit! Çdo përpjekje për mashtrim, do të raportohet dhe do të trajtohet si mashtrim në dëm të fondeve publike

Aplikacionet me vlerë të investimeve të pranueshme mbi 20,000 € duhet të përmbajnë një Plan të Biznesit- shtojca 5 ose Projekt-Propozimin,Modelin për nënmasën 302.5 Zhvillimi i turizmit rural dhe turizmi në fermë sipas modelit të paraqitur në shtojcën nr. 4. Aplikacionet me vlerë të investimeve të pranueshme deri 20,000 € duhet të përmbajnë një Projekt-Propozim sipas modelit të paraqitur shih në shtojcën nr.3.

Plani i Biznesit/Projekt-propozimet/Projekt-Propozimin,Modelin për nënmasën 302.5 janë pjesë të verifikimit dhe kontrollit nëse dokumentet janë të kompletuara dhe të pranueshme,megjithatë,disa informacione që përfshihen në këto dokumente do të merren parasysh për poentimin e aplikacioneve. Gjithashtu,këto dokumente do të duhet të paraqesin burimin e të dhënave të përdorura për plotësimin e formularit të indikatorëve.

Të dhënat/informacioni i paraqitur në këto dokumente do të kontrollohen me të gjitha bazat e të dhënave të tjera ekzistuese (Regjistrin e Fermës,Regjistrin për Identifikimin e Kafshëve,sLPIS etj.),duhet të mbështetet nga dokumentet e kërkuara - shih shtojcën 1 dhe t'i nënshtrohet kontrollit në vend para se të nënshkruhet kontrata,para pagesës së mjeteve financiare dhe pasi që projekti është përfunduar,gjatë periudhës së monitorimit x-post.

Plani i Biznesit/Projekt-Propozimi/Projekt-Propozimin,Modelin për nënmasën 302.5 duhet të respektojnë plotësisht modelin e përgatitur nga MBPZHR-ja. Ai nuk është dokument që duhet "plotësuar",por përmban në vete rekomandime se si duhet të përgatitet projekt-propozimi. Të gjithë kapitujt e tij duhet të trajtohen plotësisht,prandaj përjashtimi i një kapitulli do të çojë në refuzimin e aplikimit. Për më tepër,ekstra-kapitujt nuk do të merren parasysh gjatë vlerësimit të projektit.

Kontrollet e mëposhtme janë pjesë e vlerësimit të Projekt-Propozimit/Planit të Biznesit/Projekt-Propozimin,Modelin për nënmasën 302.5:

1. Të gjithë kapitujt dhe nënkapituj duhet të plotësohen në mënyrë të detajuar,nëse ndonjë kapitull nuk është i aplikueshëm për projekt-propozimin,ajo duhet të shpjegojë;
2. Së paku 1 (një) objektivi specifik i kësaj mase duhet të plotësohet;
3. Projekti është në përputhje me potencialin e zonës;
4. Kthimi i investimeve dëshmon që fitimi shtesë (të hyrat shtesë -kosto shtesë) mbulon kostot e investimeve (të llogaritet vetëm bashkëfinancimi privat) për së paku 10 vjet;
5. Vlerësimi se ka kapacitete të ketë mjaftueshëm(njerëzore) për drejtimin e fermës/biznesit;
6. Blerjet e propozuara të jenë në përputhje me nevojat aplikuesit(psh.: jopajisje me kapacitete që nuk u përputhen nevojave të aplikuesit);
7. Ndërtimet/rinovimet të propozuara janë në përputhje me kapacitetet e aplikuesit;
8. Kostot e vlerësuara për blerjet/ndërtimet/rinovimet të jenë arsyeshme;Aplikuesi duhet të kontrollojë nëse shpenzimet e parashikuara të shpenzimeve të tij janë në përputhje me çmimet e tregut.
9. Orari për blerjet/ndërtimet/rinovimet duhet të jetë real dhe t'i japë mundësinë e investimit. Të përfundojë më së largu deri në fund të nëntorit;
10. Kapaciteti i prodhimit para dhe pas investimit të paraqitura si dhe kapacitetet e ofrimit të shërbimeve;
11. Rritja e parashikuar në kapacitetin e prodhimit është paraqitur dhe është plotësisht në përputhje me shpenzimet e propozuara;
12. Pajisjet/teknologjia janë përshkruar;
13. Procesi teknologjik duhet të përputhet me asetet ekzistues dhe të parapara;
14. Furnizuesit e mundshëm dhe klientët potencialë janë identifikuar;(të paraqiten me kontrata apo parakontrata);
15. Strategjia e tregut është realiste;
16. Për të gjitha investimet e pranueshme dhe të papranueshme janë paraqitur saktë vlerat e ndihmës publike dhe financimeve private;
17. Për 3 vite të fundit duhet të paraqiten nëse aplikuesi ka pasur fitim apo humbje,personat juridikë duhet t'i dorëzojnë pasqyrat e të ardhurave dhe bilancin e gjendjes;

18. Bilanci i rrjedhës së parasë,në fund të çdo muaji,duhet të jetë pozitiv në 3 vite të ardhshme pas përfundimit të investimit;Shpenzimet e parapara përfshijnë: koston shtesë nga fuqia punëtore shtesë (pagat dhe kontributet),energji e konsumuar shtesë,pagesat për furnizuesit e rinj,ofruesit e shërbimeve,kthimi i huas etj.;
19. Të gjitha kostot shtesë janë të njëjta gjersa e kalkulojmë Kthimin e Investimit;
20. Të hyrat e parapara shtesë janë në përputhje me kapacitetin prodhues;
21. Të hyrat e parapara shtesë janë në përputhje me strategjinë e marketingut (psh. është e pamundur që një sasi e madhe e perimeve të shpërndahet direkt nga përfituesi në tregun e gjelbër);
22. Të hyrat shtesë në llogaritjen e Kthimit të Investimit janë në përputhje meprodhimin shtesë të paraqitur në indikatorët e ndikimit;
23. Aplikuesi nuk ka krijuar kushte artificiale për të përfituar përparësi;
24. Parashtruesi i kërkesës nuk ka krijuar kushte artificiale për marrjen e një avantazhi që është kundër objektivave të masës.

PërProjekt Propozim janë të zbatueshme kontrollet nr: 1,2,3,5,6,7,8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 16,dhe 24.

17. Kontrollet në terren dhe afati

Së paku janë 3 kontrole të parapara në terren: 1.Para së të nënshkruhet kontrata; 2. Pas kërkesës për pagesa;3. Gjatë periudhës 5-vjeçare të Monitorimit ex-post të Projektit.

Kujdes: Kur kërkohet të kontrollohet, përfituesit janë të obliguar të lejojnë qasje të lirë dhe të menjëhershme në fermë, në paisjet e fermës dhe ndonjë dokument shtesë të kërkuar nga Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë. Nëse ndodh mosrespektimi i këtij kushti, duhet të bëhet kthimi i menjëhershëm i grantit dhe ndëshkimi i aplikuesit!

18. Radhitja në listë eaplikuesve

Të gjitha projektet e pranuar duhet të radhiten në bazë të poenëve të pranuar dhe shpërndarja e mjeteve financiare bëhet duke filluar prej aplikacioneve me më shumë pikë.

19. Vendimi i dhënies së grantit dhe njoftimi i aplikuesit

Pas vlerësimit,AZHB përgatit Raportin e Vlerësimit. Projektet klasifikohen në këtë raport në: 1) projekte të papranueshme (që nuk e kanë kaluar kriterin e pranueshmërisë) dhe 2) projekte të pranueshme dhe të vlerësuara me pikë. Në rastet kur projekti është i papranueshëm ose nuk ka marrë pikë në disa kriteret,arsyet për këtë duhet të paraqiten në Letrën Informuese.

20. Ankesat

Prej ditës së pranimit të Letrës Informuese,aplikuesi ka afat 5 ditë të ushtrojë ankesë,në zyrën ku edhe e ka dorëzuar aplikacionin. Ankesës duhet t'i bashkëngjitet një kopje e letrës informuese dhe nëse ka edhe ndonjë dokument tjetër.

AZHB duhet t'i shqyrtojë ankesat dhe të publikoj raportin e ankesave bashkë me raportin përfundimtar të vlerësimit,më së largu (10) dhjetë data pas përfundimit të afatit të ankesave.

Aplikuesit duhet të marrin përgjegjen nga Komisioni i Ankesave letrënme rezultatin e vlerësimit dhe nëse ankesa e tyre është refuzuar edhe arsyet e refuzimit.

21. Kontrata me përfituesit dhe AZHB-së bashkë me procedurat e prokurimit

Të gjithë përfituesit do të nënshkruajnë një kontratë standarde – shih shtojcën nr.6. Projekt-propozimi ose plani i biznesit së bashku me të gjitha dokumentet e paraqitura bëhet pjesë e kontratës. Jetëgjatësia e kontratës mbetet në fuqi nga momenti i nënshkrimit nga të dyja Palët (Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisëdhe përfituesi) derinë përfundimin e periudhës monitoruese që është 5 vjet pas zbatimit të projektit.

22. Pagesa e grantit

Pas nënshkrimit të kontratës,përfituesi do të kërkojë kthimin e mjeteve të shpenzimeve të pranueshme,në përputhje me intensitetin e ndihmës publike,duke plotësuar formularin e ofruar nga Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë. Shih shtojcën nr. 11. Përfituesi do të bashkëngjisë provat e kryerjes së procedurave të prokurimit në kërkesën e pagesës – ashtu si i kërkohe këto procedura (përfshihet si aneks i kontratës standarde) dhe provat e pagesës (së bashku me faturat dhe provat e ekzekutimit të pagesave,p.sh. transferi bankar i cili është i miratuar/vulosur nga banka për pagesa me vlerë mbi 500 €, ndërsa për ato nën 500 €, faturat dhe kuponin fiskal). Aprovimi i pagesës do të ndodhë pas kontrollit të caktuar të dokumentit të paraqitur dhe pas kontrollit në terren të kryer nga zyrtarët e Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë

Kujdes: Në rast se përfitues janë personatjuridik,llogaria në të cilën do të kryhet pagesa nga Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë duhet të jetë e personit juridik dhe Jo në emër të pronarit. Gjithashtu nëse përfituesi është femër,llogaria bankare duhet t'i përket asaj,e jo burrit të saj dhe anasjelltas.

23. Monitorimi Ex-post

Të gjitha projektet do të monitorohen 5 vjet pas implementimit të projektit,kontrollimi do të bëhet nga Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë, Qëllimi i investimit duhet të ruhet edhe 5 vjet pas investimit. Gjithashtu,përfituesi duhet të vazhdojë t'i respektojë të gjitha kushtet e pranueshmërisë dhe kriteret e përzgjedhjes për të cilat aplikuesit janë poentuar. Nëse ndodh shkelja e këtyre rregullave, atëherë do të kthehet granti dhe përfituesi do të ndëshkohet me pagesë.

24. Dispozita të rëndësishme që mund të jenë shkaktar të refuzimit të aplikacionit

Aplikacionet mund të refuzohen nëse nuk janë të kompletuara,nëse nuk e plotësojnë kriterin e pranueshmërisë ose edhe kur e plotësojnë kriterin e pranueshmërisë mund të refuzohen për shkak të numrit të vogël të pikëve.

Kujdes: Arsyet e refuzimit duhet të paraqiten dhe sqarohen në letrën informuese të cilën Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë ia dërgon aplikuesit!

1. Në rast se zyrtari rajonal i AZHB-së ka pranuar aplikacione të pakompletuara,ato do të refuzohen gjatë kontrollit nga zyrtari i AZHB-së në Prishtinë.
2. Aplikacionet e papranueshme – deklarohen të papranueshme gjatë procesit të vlerësimit të cilin e bëjnë zyrtarët e Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë në Prishtinë. Projektet mund të deklarohen si të papranueshme gjatë kontrollit administrativ (psh. mospërputhje me të

dhënat nga Regjistri i Fermës apo Regjistri për Identifikimin e Kafshëve), gjatë vlerësimit të dokumenteve (psh. vlerësimi i Projekt-Propozimit) ose gjatë kontrollit në terren (psh. investimi është kryer më herët). Projektet e papranueshme nuk i nënshtrohen procesit të dhënies së pikëve.

Kujdes: Për aplikacionet e pakompletuara aplikuesi njoftohet menjëherë. Aplikacionet e papranueshme dhe ato të pranueshme por me numër të vogël të pikëve janë pjesë e Raportit të Vlerësimit të cilin Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë e publikon në uebfaqen zyrtare (azhb.rks-gov.net) jo më vonë se 24 orë pasi që lista e aplikuesve është e përfunduar dhe nënshkruar nga shefi i Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë. Aplikuesit duhet të njoftohen me shkrim me rezultatin e vlerësimit më së largu pesë ditë pas shpalljes së listës në uebfaqe.

25. Shtojcat

- 1.1 Shtojca1: Lista e dokumenteve të dorëzuara;
- 1.2 Shtojca 2: Formulari për aplikim;
- 1.3 Shtojca3: Modelii përgatitjes së Projekt-Propozimit;
- 1.4 Shtojca4: Modeli për përgatitjen e projekt-propozimit për nënmasën 302.5;
- 1.5 Shtojca 5: Modeli për përgatitjen e planit të biznesit;
- 1.6 Shtojca 6: Formulari i Kontratës dhe Procedurat e Prokurimit;
- 1.7 Shtojca7: Lista e Aktivitete tradicionale artizanale të pranueshme për mbështetjenë Masën 302.4;
- 1.8 Shtojca8:Lisat e investimeve të pranueshme/Shpenzimet të Pranueshme;
- 1.9 Shtojca 9: Lista A - Lista e vendbanimeve në zonat malore ("Iloji A");
- 1.10Shtojca 10: Lista B - Lista e vendbanimeve në zonat malore ("Iloji B");
- 1.11Shtojca 11: Kërkesa për Pagesë për Masën 302;
- 1.12Shtojca 12:Letra Informuese;
- 1.13Shtojca 13:Forma e Ankesës;
- 1.14Shtojca14: Formulari i indikatorëve;
- 1.15Shtojca 15: Lista me Adresa të Zyrave Rajonale të Bujqësisë;
- 1.16Shtojca 16: Logo - Promovimi;
- 1.17Shtojca 17: Lista e trashëgimisë kulturore për mbrojtje të përkohshme;
- 1.18Shtojca 18: Kodi i Etikës për kompanitë këshilluese

Shtojca 1: Lista e dokumenteve të dorëzuara

Dokumentet e kompletuara (dosja) duhet t'i ketë dokumentet e radhitura si në listën e mëposhtme dhe çdo faqe duhet të ketë të shkruar numrin (me dorë). Ky numër duhet të paraqitet në listë pranë emrit të dokumentit.

Në rast të mungesës së ndonjë dokumenti obligativ,zyrtari i AZHB-së nuk e pranon aplikacionin,por e regjistron aplikuesin dhe i jep atij një kopje të kësaj shtojce duke ja rrumbullakuar dokumentet që i mungojnë aplikuesit. aplikuesi ka afat deri në përfundim të thirrjes për aplikim që t'i kompletojë dokumentet.

Në rastet kur kërkohet vetëm kopje e dokumentit,aplikuesi e shkruan me dorë në kopje “sikur në origjinal”dhe ia sjell origjinalin në shikim zyrtarit rajonal i cili verifikon përputhshmërinë e kopjes dhe ia kthen origjinalin aplikuesit

Nr.	DOKUMENTI	Obligative	Opcionale
1.	FORMULARI PËR APLIKIM Sipas modelit të AZHB-së,preferohet të jetë i plotësuar me makinë ose kompjuter kontrolli i dokumentet. Nëse janë të plotësuarasi duhet, të bëhet në momentin e dorëzimit në prani të aplikuesit	f. --- <input type="checkbox"/>	
2.	KOPJA E LETËRNJOFTIMIT Zyrtari verifikon në prani të aplikuesit nëse është letërnjoftimi i lëshuar nga Republika e Kosovës dhe nëse është i vlefshëm në momentin e aplikimit.	f. ---- <input type="checkbox"/>	
3.	CERTIFIKATA E LINDJES, kopje	f. --- <input type="checkbox"/>	
4.	FORMULARIPËR INDIKATOR i plotësuar (në origjinal) Në prani të aplikuesit zyrtari verifikon nëse është plotësuar si duhet formulari për indikatorët.	f. <input type="checkbox"/>	
5.	LLOGARIA RRJEDHËSE , dokument i lëshuar dhe vulosur nga banka (në origjinal) Llogaria rrjedhëse duhet të jetë nga një bankë që operon në Kosovë	f. ---- <input type="checkbox"/>	
6.	Në rastin e personave juridikë: CERTIFIKATA E NUMRIT FISKAL- kopje	f. --- <input type="checkbox"/>	
7.	CERTIFIKATA E REGJISTRIT TË BIZNESIT- kopje	f. --- <input type="checkbox"/>	
8.	a) PROJEKT-PROPOZIMI- Në rast të projekteve në vlerë deri 20, 000 €; b) PLANI I BIZNESIT - Në rast të projekteve në vlerë mbi 20, 000 €; c) PROJEKT-PROPOZIMI PËR MASËN 302.5 Zyrtari verifikon nëse ky dokument është në përputhje me modelin e AZHB-së	f. ---- <input type="checkbox"/> <input type="checkbox"/> <input type="checkbox"/>	
9.	Jo të gjitha dokumentet nën pikën 9 janë të obligueshme (shih kriteret e pranueshmërisë) a) CERTIFIKATA E REGJISTRIMIT NË REGJISTRIN E FERMËS	f.	

	<p>për të dëshmuar përvojën mbi dyvjeçare në bujqësi - kopje; ose b) VËRTETIM NGA PUNËDHËNËSIse aplikuesi ka së paku njëvjet përvojë pune nëpërpunim të prodhimeve bujqësore /artizanale/hotelieri /ofrimin e shërbimeve hoteliere; ose c) DIPLOMA E FAKULTETITtë Bujqësisë,Veterinarisë apo Teknologjisë së Ushqimit/Pylltarisë/Turizmit/Hotelerisë/ose përkatës - kopjeose d) DIPLOMA E SHKOLLËS SË MESME TË BUJQËSISË e) /Pylltarisë/Turizmi/Hotelieri/përkatës - kopje; ose f) DIPLOMA E SHKOLLËS SË MESME (kopje)dhenjë DEKLARATË ME SHKRIMme të cilën zotohen se do të ndjekin kurse trajnimi më së paku 20 orë mësimi,në fushën për të cilën aplikojnë,të cilat do t'i përfundojnë para kërkesës për pagesën e fundit. g) VËRTETIMI PËR MBAJTJENe trajnimeve duhet të përmbajë programin e detajuar dhe materialet e shfrytëzuara për trajnim,temat e trajtuara dhe numrin e orëve. Nga numri i përgjithshëm i orëve së paku 30% duhet të jenë punë praktike</p>	<input type="checkbox"/> <input type="checkbox"/> <input type="checkbox"/> <input type="checkbox"/> <input type="checkbox"/> <input type="checkbox"/>	
10.	Për personat juridikë: a) VËRTETIM nga Administrata Tatimore e Kosovës që dëshmon se aplikuesi nuk ka obligime të papaguara(në original) Për personat fizikë: b) VËRTETIM nga Komuna që ka paguar tatimin në pronë	f. --- <input type="checkbox"/> f. --- <input type="checkbox"/>	
11.	Në rast të projekteve që parashohin ndërtim/ rindërtim/zgjerim: a) DOKUMENTI QË DËSHMON PRONËSINË MBI TOKËN/FLETA POSEDUESE ose b) KONTRATA E QIRAMARRJES SË TOKËS për së paku 10 vjet e vulosur nga noteri	f. --- <input type="checkbox"/> <input type="checkbox"/>	
12.	AUTORIZIMI - Në rast se aplikimi bëhet përmes një personi të autorizuar,ai pranohetvetëm përmes autorizimi të vërtetuar nga noteri	f.____ <input type="checkbox"/>	

13.	302.1 Bletaria,prodhimi/për punimi dhe marketingu i mjaltit	1. Certifikatë për prodhimin organike - (nuk është e obligueshme,por është kriter i përzgjedhjes) <input type="checkbox"/> Po <input type="checkbox"/> JO 2. Vërtetimi i qarkullimit të mjeteve (prodhim në €) gjatë dy viteve të fundit - (nuk është e obligueshme po është kriter i përzgjedhjes) a)Për biznese të regjistruara -Pasqyra financiare dhe gjendja e bilancit <input type="checkbox"/> Po <input type="checkbox"/> JO	f. --- <input type="checkbox"/> f. --- <input type="checkbox"/> f. ---
-----	--	--	---

		<p>b)Për persona fizikë Certifikatën e regjistrimit të fermës të bashkangjitur aneksin ku tregohet se sa është numri i koshereve: -Nëse numri i koshereve është 30 – 150, vlerësohet së ka pasur qarkullim vjetor prej 1000-3000 €. <input type="checkbox"/>Po<input type="checkbox"/>JO</p> <p>-Nëse numri i koshereve është mbi 150, vlerësohet së ka pasur qarkullim vjetormbi 3000 €. <input type="checkbox"/>Po<input type="checkbox"/>JO</p> <p>4.Vërtetim të anëtarësisë në shoqatë - (nuk është e obligueshme,por është kriter i përzgjedhjes) <input type="checkbox"/>Po<input type="checkbox"/>JO</p>		<input type="checkbox"/> f. --- <input type="checkbox"/> f. --- <input type="checkbox"/> f. --- <input type="checkbox"/>
14.	302.2 Përpunimi i produkteve jodrusore të malit dhe marketingu i tyre (bimëve mjekuese dhe aromatike, frutave pyjore dhe kërpudhave të grumbulluara)	<p>1. Certifikatën se aplikuesit janë të licencuar nga Departamenti i Pylltarisë i MBPZHR-së për grumbullimin e bimëve mjekuese dhe aromatike, frutave pyjore dhe kërpudhave. Ky kriter nuk vlen për aplikuesit që aplikojnë për t'u pajisur me tharëse të prodhimeve jodrusore të malit.</p> <p>2. Vërtetim qarkullim të mjeteve: (prodhimi në €) gjatë dy viteve të fundit - (nuk është e obligueshme,por është kriter i përzgjedhjes) <input type="checkbox"/>Po<input type="checkbox"/>JO</p> <p>a) Për biznese të regjistruara (pasqyra financiare dhe gjendja e bilancit) <input type="checkbox"/>Po<input type="checkbox"/>JO</p> <p>3.Certifikatë për prodhimin organik - (nuk është e obligueshme,por është kriter i përzgjedhjes) <input type="checkbox"/>Po<input type="checkbox"/>JO</p>	f. --- <input type="checkbox"/>	f. --- <input type="checkbox"/> f. --- <input type="checkbox"/> f. --- <input type="checkbox"/>
15.	302.3 - Përpunimi i prodhimeve bujqësore (të kultivuara) dhe marketingu i tyre (perimet, fruta, erëza, bimë mjekuese, kërpudhat,qumështi,m ushiti, verave, rakia nga rrushi dhe nga fruta te tjera,prodhimi i uthullës dhe përpunimin e brumërave)	<p>1. Përvoja e ekonomisë familjare /ferma/biznesinë aktivitetet e përpunimit(nuk është e obligueshme,por është kriter i përzgjedhjes) <input type="checkbox"/>Po<input type="checkbox"/>JO</p> <p>a) Persona fizikë - deklaratë</p> <p>b) Persona juridikë - Pasqyra e të ardhurave (më së paku për një vit)</p> <p>2. Në rast të përpunimit të verës:</p> <p>a) Certifikatën nga Regjistri Kadastral i Vreshtave; më pak se 4 hektarë vreshta;</p> <p>Në rast të qumështit: b)Deklaratë –se kapacitetet përpunuesenuk do të jenë më shumë se 500 l qumësht në ditë;</p>		f. --- <input type="checkbox"/> f. --- <input type="checkbox"/>

16.	302.4 - Zhvillimi i aktiviteteve artizanale dhe marketingu i tyre (përpunimii tekstilit,lëkurës,leshit, përpunimi i drurit dhe aktivitetet tjera të artit që janë punë artizanale)	<p>1. Përvojat ekonomisë familjare /ferma/biznesinë aktivitetet e përpunimit(nuk është e obligueshme,por është kriter i përzgjedhjes)</p> <p><input type="checkbox"/>Po<input type="checkbox"/>JO</p> <p>a) Persona fizikë - deklaratë; b) Persona juridikë - Pasqyra e të ardhurave (më së paku për një vit)</p> <p>2. Madhësia e familjes -Certifikata e bashkësisë familjare (nuk është e obligueshme,por është kriter i përzgjedhjes)</p>		
17.	302.5 Zhvillimi i turizmit rural dhe turizmi në fermë	<p>1. Përvoja e ekonomisë familjare /ferma/biznesinë aktivitetet e ofrimit të shërbimeve të turizmit rural /hoteliere),(nuk është e obligueshme,por është kriter i përzgjedhjes)</p> <p><input type="checkbox"/>Po<input type="checkbox"/>JO</p> <p>a)Persona fizik – deklaratë; b) Persona juridikë - Pasqyra e të ardhurave (më së paku për një vit)</p> <p>2. Aplikuesit janë të rekomanduar nga GLV-të (nuk është e obligueshme,por është kriter i përzgjedhjes)</p> <p><input type="checkbox"/>Po<input type="checkbox"/>JO</p> <p>Letër rekomandimi nga GLV-të GLV – të përzgjedhura /strategjitë e aprovuara</p>		

Shtojca 2: Formulari për aplikim

FORMULARI PËR APLIKIM

MASA 302,NËNMASA: 302.....,_____

I. Emri i aplikuesit (Emri,emri i babës,mbiemri ose subjekti juridik)										
	Nr. letërnjoftimit										
	Komuna:										
	Vendbanimi:										
	Adresa:										
	Telefoni:										
	E-mail:										
	Uebfaqja:										
Statusi juridik: Person fizik <input type="checkbox"/> Entitet juridik <input type="checkbox"/>											
II. Emri i projektit	_____										
- _____											
- _____											
<i>Vetëm për përdorim zyrtar(të plotësohet nga shërbyesi civilrajonal):</i>											
Numri unik regjistruar i projektit (NUR): _____											

III. Data:	_____ (dd/mm/vvvv)
IV. Koha:	_____ (ora dhe minuta,të plotësohet vetëm kur aplikacioni të jetë kompletuar)
V. Aplikacioni është kompletuar	PO JO
<i>Vetëm për përdorim zyrtar(të plotësohet nga zyrtari i zyrës rajonale)</i>	

VI. Numri (NIF) nga Regjistri i Fermës:																				
VII. Për personat juridikë, Numri regjistruar i biznesit:																				
VIII. Për të gjithë aplikuesit:																				
Banka	Emri i bankës:																			
	IBAN:																			
	Nr. Llogarisë rrjedhëse:																			
	Adresa:																			

Në rast se aplikimi bëhet përmes një personi të autorizuar, ai pranohet vetëm përmes autorizimit të vërtetuar nga noteri i cili dorëzohet në origjinal, dhe të autorizuarit i merren të dhënat e mëposhtme		
Emri _____	Numri personal	<input type="text"/>
Emri i Babës _____		<input type="text"/>
Mbiemri _____	Nr. i letërnjoftimi	<input type="text"/>
E-mail: _____		
VIII. Deklaratat		
Të gjitha të dhënat, informatat dhe dokumentacionin, të cilin unë kam paraqitur në këtë formular për aplikim janë të vërteta.		
Unë pranoj se:		
<input type="checkbox"/> Nuk kam pranuar grant nga MBPZHR në 2 vitet e fundit, <input type="checkbox"/> kam pranuar grant nga MBPZHR në 2 vitet e fundit		
Unë do të krijoj vende të reja të punës si rezultat direkt i zbatimit të projektit – siç është paraqitur brenda Projekt-Propozimit ose Planit të Biznesit		
<input type="checkbox"/> Po unë nuk do të krijoj _____ VENDE të reja të punës siç dëshmon dokument _____		
<input type="checkbox"/> Jo nuk do të krijoj vende të reja të punës		
<input type="checkbox"/> Po, unë kam arsim formal për fusha të caktuar dhe më shumë se 2 vjet përvojë relevante – siç dëshmon dokument nr. _____ dhe nr. _____ të bashkangjitur. _____		
<input type="checkbox"/> Jo, nuk do të kem arsim formal bujqësor dhe më shumë se 2 vjet përvojë relevante.		
IX. Zotimet		
Unë zotohem se do të siguroj pjesën e bashkëfinancimit dhe shpenzimet e papranueshme të projektit.		
Unë zotohem se do të vazhdoj aktivitetet dhe mirëmbajtjen e investimit të mbështetur edhe paku 5 vjet të ardhshme pas zbatimit të projektit.		
Të gjitha të dhënat, informatat dhe dokumentacionet, të cilin unë e kam paraqitur në këtë formular për aplikim janë të vërteta. Jam i vetëdijshëm se paraqitja e të dhënave të pavërteta ndëshkohet me ligjet e vendit.		
Nënshkrimi i aplikuesit _____		

X. Kalkulimi dhe përqindja e përkrahjes së shpenzimeve të pranueshme është 65% për Masën.

Tabela e shpenzimeve (€) – sikur është paraqitur në Projekt-Propozim/Plan Biznesi/ Projekt-Propozimin Modelin për nënmasën 302.5

Shpenzimet e pranueshme (pa TVSH)	Përqindja e përkrahje 65%	Përkrahja publike (të llogaritet për qindja e përkrahjes nga shpenzimet pranueshme -pa TVSH)	Bashkë-financimi

Emri, mbiemri dhe
nënshkrimi i aplikuesit)

(Emri, mbiemri dhe
nënshkrimi i zyrtarit rajonal)

Data

Dokumentet e kompletuara (dosja) duhet t'i ketë dokumentet e radhitura si në listën e mëposhtme dhe çdo faqe duhet të ketë të shkruar numrin (me dorë). Ky numër duhet të paraqitet në listë pranë emrit të dokumentit.

Në rast të mungesës së ndonjë dokumenti obligativ, zyrtari i AZHB-së nuk e pranon aplikacionin, por e regjistron aplikuesin dhe i jep atij një kopje të kësaj shtojce, duke ia rrumbullakuar dokumentet që i mungojnë aplikuesit. Aplikuesi ka afat deri në përfundim të thirrjes për aplikim që të kompletojë dokumentet. Në rastet kur kërkohet vetëm kopje e dokumentit, aplikuesi e shkruan me dorë në kopje "sikur në origjinal" dhe iasjell origjinalin në shikim zyrtarit rajonal i cili verifikon përputhshmërinë e kopjes dhe ja kthen origjinalin aplikuesit.

Shtojca 3: Model për përgatitjen e projekt-propozimit



Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë

MODEL PËR PROJEKT-PROPOZIM

Emri kompanisë konsulente - nëse projekt-propozimi është përgatitur nga një kompani konsulente.

SHËNIM! Ky dokument duhet të respektohet në tërësi. Ky dokument nuk është për t'u plotësuar por është një model si të shkruhet projekt-propozim. Në rast se ekziston ndonjë kapitull që nuk ndërlidhet me projektin tuaj, ju duhet që një gjë të tillë ta cekni brenda kapitullit përkatës.

1. Informata të përgjithshme

1.1 Emri i aplikuesit (me të dhënat e tij specifike të identifikimit)

1.2 Asetet kryesore në pronësi të përfituesit: tokë (me specifikim të llojit të pronësisë), objekte, pajisje dhe makineri, kafshë etj.

Tabela 1. Asetet e aplikuesit

Asetet	Data e blerjes / ndërtimi	Vlera e blerjes për persona fizikë ose gjendja e fundit e bilancit për persona juridikë	Sasia (me copë)
1. Objektet - gjithsej			
1.1 detaje.....			
1. n detaje.....			
2. Pajisje - gjithsej			
2.1 detaje.....			
2. n detaje.....			
3. KAFSHË			
3.1 detaje.....			
3. n detaje.....			
4. Të tjera - detaje			
GJITHSEJ			

Tabela 2. Toka

Nr.	Rajoni/Komuna/Fshati	Sipërfaqja (m ²) / lloji i shfrytëzimit	Statusi juridik
1			
n			

2. Përshkrimi i projektit

2.1 Emërtimi i investimit

2.2 Vendi i projektit (rajoni, komuna dhe fshati)

2.3 Qëllimi, me përshkrimin e objektivave, arsyesimit të nevojës dhe mundësisë së investimit

3. Të dhëna lidhur me fuqinë punëtore dhe menaxhimin e projektit

2.1 Menaxheri teknik juridik (emri, mbiemri, pozita brenda organizatës, studimet relevante dhe përvoja profesionale).....

2.2 Numri i përgjithshëm i punonjësve aktualë.....

prej të cilëve..... me detyra ekzekutive

2.3 Vlerësimet rreth fuqisë punëtore që do të angazhohet për zbatimin e projektit

prej të cilave vende të reja pune për zbatimin e projektit.....

4. Përshkrimi i blerjeve të kryera përmes projektit

Emri, numri, vlera, karakteristikat teknike dhe funksionale të makinerisë / pajisjeve / teknologjive / mjeteve të transportit / pajisjeve që do të blihen përmes projektit dhe, nëse është e nevojshme, prezantimi teknik i objekteve ku do të vendosen pajisjet dhe mjetet. Prokurimet duhet të bazohen në kapacitetet aktuale dhe / ose të parashikuara të prodhimit.

Tabela 3. Përshkrimi i blerjeve të kryera përmes projektit

Nr.	Emri / lloji i pajisjeve / makinerisë	Njësitë	Vlera pa TVSh	TVSh	Gjithsej vlera me TVSh	Përqindja e përkrahjes publike
GJITHSEJ						

Shënim! Nuk është e lejuar që të ceken emrat e prodhuesve, markat tregtare, emrat e ofertuesve etj.

5. Kalendarizbatimit (muajt) dhe fazat kryesore

Orari i investimit i shprehur me vlera, muaj dhe aktivitete.

Tabela 4. Shembull/Orari për shpërndarje

Lloji i investimit dhe kostoja totale (€)	Viti (psh.2015)		
	Muajt 1	Muajt 2	Muajt 3
Psh. tavolina për pastrim	5000		
Psh. makineria për klasifikim		5000	
Psh.makineria për tharje			5000

Tabela 5. Shembull/Orari për ndërtimin e objekteve të reja

Lloji i investimit dhe kostoja totale (€)	Viti (ex. 2015)		
	Muajt 1	Muajt 2	Muajt 3
Psh. përbërësit e ndërtimit	5000		
Psh. ndërtimi i katit të 1-rë pa dritare dhe kulm		5000	
psh.kati i 1-rë dritaret dhe kulmi			5000

6. Kapaciteti prodhues

Kapaciteti prodhues që rezulton nga investimi (në njësi fizike kg/ tonë).

Duhet të sillen specifikat lidhur me kapacitetin ekzistues para dhe pas finalizimit të investimit.

Duhet të bëhet përshkrimi i procesit teknologjik të përpunimit që aplikohet në projekt

Të paraqitet pjesëmarrja (në%) e lëndës së parë të prodhuar në fermën e aplikuesit në procesin e përpunimit.

7. Furnizimi i tregut / shitja

Tabela 6. Furnizuesit potencialë të aplikuesit

Furnizuesit potencialë të aplikuesit				
Emri i furnizuesit me lëndët e para/ materialet ndihmëse/produktet / shërbimet	Adresa	Produkti furnizues dhe shuma e përafërt	Vlera e llogaritur	% nga shpërndarja totale
1.				
2.				
3.				

Tabela 7. Klientët potencialë të aplikuesit

Klientët potencialë të aplikuesit			
Nr.	Klienti (Emri dhe adresa)	Vlera	% e shitjes
1.			
2.			
3.			

8. Detaje financiare të investimit

Tabela 8. Shpenzime të detajuara të pranueshme dhe të papranueshme

Shpenzime e pranueshme	Përqindja e ndihmës publike	Ndihma publike (% e ndihmës publike nga vlera e pranueshme pa TVSh)	Bashkëfinancimi privat (duke përfshire totalin TVSH)	Totali
(Investimet e ndara në pjesë)	...%			
.....				
Kosto administrative				
Investimet e papranueshme	X	X		
Total				

Shtojca 4: Model për përgatitjen e projekt-propozimit për nënmasën 302.5



Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë

SHËNIM! Ky dokument duhet të respektohet në tërësi. Ky dokument nuk është për t'u plotësuar por është një model si të shkruhet projekt-propozimi. Në rast se ekziston ndonjë kapitull që nuk ndërlidhet me projektin tuaj, ju duhet që një gjë të tillë ta cekni brenda kapitullit përkatës. Informata të përgjithshme

1.1 Emri i përfituesit (me të dhënat e tij specifike të identifikimit)

1.2 Asetet kryesore në pronësi të përfituesit: tokë (me specifikim të llojit të pronësisë), objekte, pajisje dhe makineri, kafshë etj. - sikur ne regjistrin e fermës

Tabela 1. Asetet e aplikuesit. Në rast se asetet i takojnë anëtarëve tjerë të familjes, ato duhet të përfshihen si biznes familjar dhe poashtu brenda tabelës së mëposhtme, por duhet të theksohet në kolonën e parë se kush është pronari.

Asetet	Data e blerjes / ndërtimi	Vlera e blerjes për persona fizikë ose gjendja e fundit e bilancit për persona juridikë	Sasia (me copë)
1. Objektet - gjithsej			
1.1 detaje.....,adresa:			
1. n detaje.....,adresa:...			
2.Pajisje - gjithsej			
2.1 detaje.....			
2. n detaje.....			
3. KAFSHË			
3.1 detaje.....			
3. n detaje.....			
4. Të tjera - detaje			
GJITHSEJ			

Tabela 2. Toka

Nr.	Rajoni/Komuna/Fshati (dhe pronari nëse nuk i takojnë aplikuesit)	Sipërfaqja (m ²) / lloji i shfrytëzimit	Statusi juridik (toka në emër të aplikuesit apo e marrë me qira)
1			
n			

2. Përshkrimiprojektit

2.1 Emërtimi i investimit

2.2 Vendi i projektit (rajoni, komuna dhe fshati)

2.3 Qëllimi, me përshkrimin e objektivave, arsytimit të nevojës dhe mundësisë së investimit.

1 3. Të dhëna lidhur me fuqinë punëtore

Tabela 3. Personat aktivë në ekonominë familjare:

Nr..	Emri e mbiemri	Mosha (në vite)	Afërsia familjare me aplikuesin	Përgatitja profesionale	Përvoja në ekonomi familjare
1.					
2.					
3.					
4.					
5.					

Tabela 4. Personat e punësuar jashtë ekonomisë familjare (nëse në ekonominë familjare janë të angazhuar personat që nuk janë anëtarë të familjes)

NR.	Emri e mbiemri	Mosha (në vite)	Përgatitja profesionale	Sa janë aktiv në punësim (orë pune për ditë)
1.				
2.				
3.				
4.				
5.				

2 3.Përshkrimi i blerjeve të kryera përmes projektit / karakteristikat e objekteve

tradicionale / Diversifikimi i aktivitetit në fermë - nëse ky është rasti.

Emri,numri,vlera,karakteristikat teknike dhe funksionale të makinerisë / pajisjeve / teknologjive / mjeteve të transportit / pajisjeve që do të blihen përmes projektit dhe,nëse është e nevojshme,prezantimi teknik i objekteve ku do të vendosen pajisjet dhe mjetet.

Blerjet dhendërtimi duhet të bazohen në kapacitetet aktuale dhe/ose të parashikuara të prodhimit. Në rast të ndërtimit,ju lutemi përdorni shtojcën e këtij dokumenti.

Tabela 5. Përshkrimi i blerjeve të kryera përmes projektit

Nr.	Emri / lloji i pajisjeve / makinerisë / ndërtimi / shërbimet	Njësitë / m ² për ndërtesa / ditë pune përshërbime	Vlera pa TVSh	TVSh	Gjithsej vlera me TVSh	Përqindja e përkrahjes publike
1.						
2.						
3.						
GJITHSEJ						

Shënim! Nuk është e lejuar që të cekën emrat e prodhuesve,markat tregtare,emrat e ofertuesveetj.

4. Kalendarri zbatimit (muajt) dhe fazat kryesore

Orari i investimit i shprehur me vlera,muaj dhe aktivitete.

Tabela 6. Shembull/Orari për shpërndarje

Lloji i investimit dhe kostoja totale (€)	Viti (p.sh.: 2015)		
	Muaji 1	Muaji 2	Muaji 3
Psh.pajisje për mobilimin e dhomave	5000		
Psh.pajisje për mobilimin e kuzhinës etj.		5000	
			5000

Tabela 7. Shembull/Orari për rinovim/zgjerimtë objekteve

Lloji i investimit dhe kostoja totale (€)	Viti (ex.: 2015)		
	Muaji 1	Muaji 2	Muaji 3
psh. përbërësit e ndërtimit	5000		
psh. Ndërtimi i katit të 1-rë pa dritare dhe		5000	

kulm			
psh.kati i 1-rë dritaret dhe kulmi			5000

5. Kapaciteti prodhues

Kapacitetet prodhuese që rezultojnë nga investimi (në njësi fizike). Duhet të sillen specifikat lidhur me kapacitetin ekzistues para dhe pas finalizimit të investimit. Do të jepet përshkrimi i rrjedhës teknologjike të punës që aplikohet në teknologjinë e projektit. Duhet të shpjegohet lloji i prodhimet - nëse është tradicional. Në rast të turizmit, në projekt duhet të paraqitet lloji i turizmit, veçanërisht për agroturizmin.

Në rast të agroturizmit, duhet të paraqitet përgatitja e ushqimit nga prodhimet fermë

Tabela 8. Lloji dhe kapaciteti i objektit

Kapaciteti i objektit	Para investimit	Pas investimit
Numri i shtretërve për fjetje		
Numri i ulëseve		
Numri i tavolinave		
Numri i banjove		
Numri i kateve		
Vëllimi i përgjithshëm i ndërtimit		
Sipërfaqja e përgjithshme ² e ndërtimit		
Tjera detaje - nëse shihen si të nevojshme nga aplikuesit		

(Këtë e plotësojnë ata që dëshirojnë që investimin ta bëjnë për rinovim/adaptim/zgjerim të objektit)

7. Furnizimi i tregut / shitja

Tabela 9. Furnizuesit potencial të aplikuesit

Furnizuesit potencial të aplikuesit				
Emri i furnizuesit me lëndët e para/ materialet ndihmëse/produktet / shërbimet	Adresa	Produkti furnizues dhe shuma e përafërt	Vlera e llogaritur	% nga shpërndarja totale
1				
2				
N				

Tabela 10. Klientët potencialë të aplikuesit

Klientët potencialë të aplikuesit			
Nr.	Klienti (Emri dhe adresa)	Vlera	% e shitjes
1			
2			
n			

8. Detaje financiare të investimit Tabela 11. Shpenzime të detajuara të pranueshme dhe të papranueshme

Shpenzimet e pranueshme	Përkrahja publike	Bashkëfinancimi privat (€)	Totali
Investimet e pranueshme			
...			
Shpenzimet administrative (psh. për projekt-propozim)			
Investimet e papranueshme			
TOTALI			

9. Rrjedhja e parasë - Cash-floë- vetëm për projektet me shpenzime të pranueshme më shumë se 20000 € (ju lutemi përdoreni xls format dhe pastaj printojeni dhe bashkëngjitjani projektit)

Tabela 12.Rrjedhja e parasë-Cash-floë					
Të hyrat			Shpenzimet		Saldo (€)
Data	Artikulli	Vlera (€)	Artikulli	Vlera (€)	Vlera fillestare
Viti 1			Lëndët e para kryesore		Nëse në këtë kolonë paraqitet një vlerë negative,projekti duhet të refuzohet si i papranueshëm
			Fuqia punëtore		
			Rryma,uji		
			Transporti/karburanti		
			Mirëmbajtja dhe riparimet		
			Këstet e kredisë		
			Investime të reja		
	Tjera		Tjera		
	Totali	...	Totali	...	
Viti 2			Lëndët e para kryesore		
			Fuqia punëtore		
			Rryma,uji		
			Transporti/karburanti		
			Mirëmbajtja dhe riparimet		
			Këstet e kredisë		
			Investime të reja		
	Tjera		Tjera		
	Totali	...	Totali	...	
Viti 3			Lëndët e para kryesore		
			Fuqia punëtore		

			Rryma,uji		
			Transporti/karburanti		
			Mirëmbajtja dhe riparimet		
			Këstet e kredisë		
			Investime të reja		
	Tjera		Tjera		
	Totali	...	Totali

Shtojca – Informata minimale duhet të ofrohen në qoftë se projektet përfshijnë punë ndërtuese

1. Karakteristikat kryesore të ndërtimit:

- pozita e ndërtesës brenda tokës në pronësi, skica e tokës;
- sipërfaqja në tokë- përfshirë skicën;
- sipërfaqja totale bashkë me bodrum;
- numri i kateve – të skicuara për çdo kat;
- lartësia – duke përfshirë skicat e fasadës të parapara me dritare ose dyer;
- vëllimi i ndërtesës;
- materialet që duhet të përdoren,

Të gjitha skicat duhet të kenë titull dhe shkallë.

Ndikimi i rolit të secilës ndarje të ndërtesës është obligative.

2. Përmirësimet dhe shërbimet e ndërtesës kryesore: gjeneratorët për ngrohje, hidroforët etj.

3. Prezantimi i rrjeteve ekzistuese të shërbimeve.

4. Në rast të ndërtimit/ zgjerimit të rrjeteve jashtë ndërtesës, për lidhje me rrjetet e shërbimeve (p.sh, për ujë, kanalizim etj.), prezantimin e:

- gjatësisë,
- gjerësisë,
- diametri,
- materialet që do të përdoren, sasi të.

5. Të dhënat kryesore mbi rrjetet brenda ndërtesës (psh. energjia elektrike, drita, uji, kanalizimi, ventilimi): forca, intensiteti, rrjedha e ujitjes etj.

Shtojca 5: Model për përgatitjen e planit të biznesit



Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë

MODEL PËR PËRGATITJEN E PLANIT TË BIZNESIT

Për projektet e përkrahura nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural

SHËNIM! Ky dokument duhet të respektohet në tërësi. Ky dokument nuk është për t'u plotësuar por është një model si të shkruhet plani i biznesit. Në rast se ekziston ndonjë kapitull që nuk ndërlidhet me projektin tuaj, ju duhet që një gjë të tillë ta cekni brenda kapitullit përkatës.

1. Informata të përgjithshme

1.1 Emri i përfituesit (me të dhënat e tij specifike të identifikimit)

1.2 Asetet kryesore në pronësi të përfituesit: tokë (me specifikim të llojit të pronësisë), objekte, pajisje dhe makineri, kafshëetj. – sikur në Regjistrin e fermës.

Tabela 1. Asetet e aplikuesit

Asetet	Data e blerjes/ ndërtimit	Vlera e blerjes për persona fizikë ose gjendja e fundit e bilancit për persona juridikë	Sasia (me copë)
1. Objektet - gjithsej			
1.1 detaje.....			
1. n detaje.....			
2. Pajisje - gjithsej			
2.1 detaje.....			
2. n detaje.....			
3. KAFSHË			
3.1 detaje.....			
3. n detaje.....			
4. Të tjera - detaje			
GJITHSEJ			

Tabela 2. Toka

Nr.	Rajoni/Komuna/Fshati	Sipërfaqja (m ²) / lloji i shfrytëzimit	Statusi juridik (pronë e aplikuesit, pronë familjare apo e marrë me qira)
1			
n			

2. Përshkrimiprojektit

2.1 Emërtimi i investimit

2.2 Vendi i projektit (rajoni, komuna dhe fshati)

2.3 Qëllimi, me përshkrimin e objektivave, arsyetimit të nevojës dhe mundësisë së investimit

2.4 Duhet të ceket përputhshmëria mes objektivave të masës dhe objektivave të projektit.

Sqarime për objektivat e përgjithshme dhe së paku për njëren prej objektivave të projektit duhet të bëhet paraqitja sipas tabelës në vijim:

Tabela 3. Harmonizimi i objektivave të programit me ato të projektit

Objektivat e përgjithshme dhe specifike	Objektivat e projektit (Shkruaj "x" në katrorin pranë objektivit të arritur)	Përshkrimi se si projekti synon që të arrijë objektivat (shkruaj brenda katrorëve të kësaj kolone paralel me objektivin e nënmasës)
<i>Aftësia konkurruese</i>	<input type="checkbox"/>	
Së paku një prej objektivave specifike në vijim:		
Objektiva specifike të masës dhe nënmasës Hartuesi i projektit i merr objektivat e masës dhe nënmasës nga programi dhe i paraqet në këtë kolonë	<input type="checkbox"/> <input type="checkbox"/> <input type="checkbox"/>	

3. Të dhëna lidhur me fuqinë punëtore dhe menaxhimin e projektit

1.1 Menaxheri teknik juridik (emri,mbiemri,pozita brenda organizatës,studimet relevante dhe përvoja profesionale).....

1.2 Numri i përgjithshëm i punonjësve aktualë.....

prej të cilëve..... punëtorë

1.3 Vlerësimet rreth fuqisë punëtore që do të angazhohet pas zbatimit tëprojektit

Numri i vendeve të reja të punës të krijuara si rezultat i investimit:.....

4. Përshkrimi i blerjeve të kryera përmes projektit

Emri,numri,vlera,karakteristikat teknike dhe funksionale të makinerisë / pajisjeve / teknologjive / mjeteve të transportit / pajisjeve që do të blihen përmes projektit dhe,nëse është e nevojshme,prezantimi teknik i objekteve ku do të vendosen pajisjet dhe mjetet. Blerjet duhet të bazohen në kapacitetet aktuale dhe /ose të parashikuara të prodhimit.

Tabela 5. Përshkrimi i blerjeve/investimeve të kryera përmes projektit

Nr.	Emri / lloji i pajisjeve / makinerisë /shërbimeve etj.	Njësitë (m ² ,ditë pune,kg,etj.)	Vlera pa TVSh	TVSh	Gjithsej vlera me TVSh	Përqindja e përkrahjes publike
GJITHSEJ						

Shënim! Nuk është e lejuar që të ceken emrat e prodhuesve,markat tregtare,emrat e ofertuesveetj.

5. Kalendarri zbatimit (muajt) dhe fazat kryesore

Orari i investimit i shprehur me vlera,muaj dhe aktivitete.

Tabela 6. Planifikimi kohor i realizimit të investimeve

Lloji i investimit dhe kostoja totale (€)	Viti (p.sh: 2015)		
	Muaji 1	Muaji 2	Muaji 3
Psh.përgatitja e tokës	5000		
Psh. mbjellja e fidanëve		15000	
Psh.sistemi mbajtës			8000

Tabela 7. Planifikimi kohor për ndërtimin e objekteve të reja

Lloji i investimit dhe kostoja totale (€)	Viti (ex.: 2015)		
	Muaji 1	Muaji 2	Muaji 3
Psh. përbërësit e ndërtimit	5,000		
Psh. ndërtimi i katit të 1-rë		10,000	
Psh. kati i 1-rë dritaret dhe kulmi			5,000

8. Kapaciteti prodhues

Kapacitetet prodhuese që rezultojnë nga investimi (në njësi matëse). Duhet të paraqiten specifikimet lidhur me kapacitetin para dhe pas finalizimit të investimit. **Duhet të jepet përshkrimi i rrjedhës teknologjike të punës që aplikohet në teknologjinë e projektit.**

9. Furnizimi i tregut / shitja

Tabela 8. Furnizuesit potencialë të aplikuesit

Furnizuesit potencialë të aplikuesit				
Emri i furnizuesit me lëndët e para/produktet / shërbimet (kur furnitori është vendor të vendoset shenja "V" pas emrit)	Adresa	Produkti furnizues dhe shuma e përafërt	Vlera e llogaritur	% nga shpërndarja totale
1				
2				
N				

Tabela 9. Klientët potencialë të aplikuesit

Klientët potencialë të aplikuesit			
Nr.	Klienti (Emri dhe adresa) kur blerësi është vendor të vendoset shenja "V" pas emrit	Vlera	% e shitjes
1			
2			
N			

10. Konkurrenca dhe strategjia e tregut

Përshkrimi i konkurrencës lokale dhe ndërkombëtare. Përshkrimi i strategjisë së tregut.

11. Detaje financiare të investimit

Tabela 10. Shpenzime të detajuara, të pranueshme dhe të papranueshme

Shpenzimet e pranueshme	Ndihma publike	Bashkëfinancimi privat (€)	Totali
Investimet e pranueshme			
...			
Shpenzimet administrative (për shembull: planin e biznesit)			
Investimet e papranueshme			
TOTALI			

11. Rrjedhja e parasë (hyrje-daljet)

Parashikimi i hyrjeve dhe daljeve për 3 vjet pas finalizimit të investimit. Aplikuesi duhet të demonstrojë se ekonomia e tij do të jetë fitimprurëse dhe se paratë e gatshme në muaj nuk do të kenë vlerë negative. Nëse aplikuesi planifikon të marrë kredi, atëherë shumën e parave të marrë nga kredia regjistrohet si hyrje, kurse kështu mujore për kthimin e kredisë regjistrohen si shpenzim.

Personat juridikë me përvojë duhet t'i dorëzojnë pasqyrat e të ardhurave për tri vitet e fundit që i kanë dorëzuar në Administratën Tatimore.

Tabela 11. Rrjedhja e parasë (Ju lutemi, shfrytëzoni tabelën në excel publikuar në uebfaqe e AZHB)

	Të hyrat		Shpenzimet		Para të gatshme në dispozicion (€)
	Artikulli	Vlera (€)	Artikulli	Vlera (€)	
Të hollat fillestare 2013, Muajt					
Janar					Të hollat fillestare + Të ardhurat - Shpenzimet = Duhet të jenë pozitive
Shkurt				
.....				

Shënim: Parashikimet për projektin e dorëzuar duhet të bazohen në gjendjen financiare të vitit të kaluar. Duhet të merren parasysh lidhja midis shitjes, parashikimit, kapacitetit të prodhimit dhe parakontratave të shitjes.

Shtojca 6: Formulari i Kontratës dhe Procedurat e Prokurimit

Kontrata për financimin e projekteve investuese të zhvillimit rural

Masa/Nënmasa.....

Kontrata për financimin e projekteve investuesetë zhvillimit rural

Nr.....

Në mes të:

Agjencia për Zhvillim e Bujqësisë (AZHB),adresa....., nr.

i..... telefonit..... përfaqësuar ngaShefi i

Agjencisë për Zhvillim e Bujqësisë(AZHB),në një të anë,

dhe

Zotëriut/Zonjës.....,

Numri personal.....,

Numri unik i identifikimit në regjistrin e

fermerëve.....,

si person fizik ose si përfaqësues i personit

juridik.....,

numri fiskal.....,

adresa.....,

nr. i telefonit.....,

si përfitues,në anën tjetër,

Në këtë dokument të ashtuquajturat "Palët",

pajtohen të nënshkruajnë kontratën sipas formularit për aplikim <numrit të regjistrimit>,shtojcave dhe në <titullin> e projektit të paraqitur nga përfituesi dhe shtojcat e saj sipas kushteve të mëposhtme:

Neni. 1 - Dispozita të përgjithshme

1.1 Ky dokument duhet të krijojë kornizë juridike dhe operative për AZHB-së për financimin e projektit të Përfituesit <numrin e regjistrimit>

1.2 Përfituesi do të financohet sipas kushteve të parapara në kontratë,për të cilat përfituesi deklaron se i njeh dhe i pranon.

1.3 Pjesë obligative të kontratës janë:

a) Formulari i aplikimit dhe shtojcat e saj

b) Projekti (plani i biznesit ose projekt-propozimi) dhe shtojcat e projektit të paraqitura nga përfituesi,pas vlerësimit (pranueshmëria dhe kriteret përzgjedhëse për të cilat janë dhënë pikët),së bashku me të gjitha modifikimet që janë bërë gjatë vlerësimit.

Përfituesi është i obliguar t'i respektojë tërësisht këto kushte gjatë implementimit (derisa të bëhet pagesa e fundit) dhe 5 vjet pasi që të bëhet pagesa e fundit,gjatë periudhës së monitorimit.

1.4 Përfituesi pranon ndihmën publike dhe do të angazhohet për zbatimin e projektit në përgjegjësinë e vet duke respektuar dispozitat e kësaj kontrate dhe legjislacionin kombëtar

Neni. 2 - Implementimi dhe vlefshmëria e kontratës

2.1 Implementimi i kontratës fillon prej momentit që kontrata është nënshkruar nga të dyja palët. Koha e implementimit të investimit është.....muaj,siç është paraparë në masë dhe paraqet afatin për kërkesën e fundit të pagesës.

2.2 Vlefshmëria e kontratës përfshin periudhën kohore prej momentit të nënshkrimit të kontratës deri tek ekzekutimi i pagesës së fundit dhe 5 vjet të periudhës monitoruese e cila llogaritet nga data e ekzekutimit të pagesës së fundit.

Neni. 3- Vlera e Kontratës

3.1 Vlera totale e përkrahjes publike të projektit të financuar është <në nr> dhe <në shkronja>.

3.2 Vlera totale e pranueshme e projektit është <në nr> dhe <në shkronja>.

3.3 Vlera totale e projektit (përkrahja publike + bashkëfinancimi privat + shpenzimet e papranueshme) është <në nr> dhe (<në shkronja>).

Neni. 4- Pagesa

4.1 Pagesa mund të bëhet në dy këste në rast të projekteve me vlerë 20000 € ose më shumë të shpenzime të pranueshme dhe në një këst në rast të projekteve më të vogla se 20000 €.

4.2 Në rastin kur përfituesi ka të drejtë të paraqesë 2 kërkesa për pagesë, kërkesa e 1-rë duhet të jetë më e madhe se 50% e totalit të ndihmës publike. Shpenzimet e pranueshme administrative (që kanë lidhje me përgatitjen teknike të projektit, planin e biznesit, inxhinieret, arkitektët etj.), mund të kërkojnë si rimbursim në përputhje me përqindjen e kështit.

4.3 Pagesa duhet të ekzekutohet duke u bazuar në kërkesën e pagesës së paraqitur nga përfituesi tek AZHB. Autorizimet e pagesës do të bëhen në bazë të dokumentacionit të paraqitur nga përfituesi dhe rezultateve të kontrollit sipas udhëzimeve administrative të AZHB-së. Çdo autorizim i pagesës mund të bëhet i pavlefshëm në rast të ndonjë parregullsie të vërejtur, gjatë vlefshmërisë së kontratës.

Neni 5 - Kontrollimi dhe monitorimi i projektit gjatë vlefshmërisë së kontratës

5.1 Përfituesi është i obliguar t'i japë qasje të plotë çfarëdo kontrole të bërë nga AZHB që ka lidhje me investimin e bërë, duke përfshirë të dhënat mbi punëtorët, kontabilitetin dhe taksat e paguara.

5.2 Në qoftë se AZHB vëren se investimi publik i financuar nuk është përdorur sipas qëllimit të tyre, planit teknik të projektit dhe planit të biznesit, ose është shitur ose dhënë me qira, AZHB ka të drejtë dhe obligim që të kërkojë kthimin e shpenzimeve të bëra.

5.3 Përfituesi është përgjegjës që ta ruajë qëndrueshmërinë ekonomike të investimit dhe ta demonstrojë dobishmërinë e tij publike.

Neni. 6 - Plotësime të Kontratës

6.1 Përfituesi mund të kërkojë që të bëhen modifikime në kontratë vetëm në qoftë se ato nuk ndryshojnë pranueshmërinë dhe rezultatin e projektit dhe vetëm gjatë periudhës implementuese. Sidoqoftë, këto modifikime nuk mund të kenë efekt retroaktiv. Modifikimet mund ta atakojnë aspektin financiar dhe teknik vetëm në qoftë se janë në përputhshmëri me masën, nëse nuk ndryshojnë qëllimin kryesor të projektit dhe nëse janë të limituara në maksimum 10% të totalit të shpenzimeve të pranueshme.

6.2 Mbështetja totale publike që është aprovuar fillimisht nuk mund të rritet në asnjë rrethanë.

6.3 AZHB mund të miratojë ndryshime/plotësime të kontratës sipas kërkesës së përfituesit, duke u bërë ato pjesë të kontratës.

6.4 Të drejtat dhe obligimet e kontratës nuk mund të jepen nga përfituesi i palës së tretë pa ndonjë marrëveshje specifike nga AZHB. Në këso raste AZHB ka për detyrë që tambikëqyrë në vazhdimësi mirëmbajtjen e kritereve të pranueshmërisë dhe atyre të përzgjedhjes.

Neni. 7 - Ndërprerja e Kontratës

7.1 Vetëm në rrethana të jashtëzakonshme dhe të argumentuara mirë, duke përfshirë "force majeure", pasi të diskutohet mes palëve, AZHB mund të vendosë që të ndërpresë kontratën pa miratimin e përfituesit, dhe ta kthejë mbështetjen e marrë publike.

7.2. Palët mund të vendosin në ndërprerjen e Kontratës sipas një marrëveshjeje të përbashkët, në këtë rast përfituesi duhet ta kthejë të gjithë mbështetjen e marrë publike.

7.3 Në rast të vërejtjes së ndonjë parregullsie në ekzekutimin e kontratës, duke përfshirë rastet kur përfituesi nuk është në gjendje ta bëjë pagesën apo ka falimentuar, ose nëse është vërejtur se dokumentet e ofruara janë të rreme/skaduara/jo të plota/nuk pasqyrojnë realitetin, atëherë AZHB duhet ta ndërpresë kontratën duke e njoftuar me shkrim përfituesin, pa asnjë vonesë dhe pa asnjë formalitet tjetër dhe pa ndërhyrje të ndonjë ligji apo gjykate. Në rast të tillë përfituesi duhet ta kthejë tërë mbështetjen e marrë.

7.4 Në çdo kohë, në rast të ndonjë dyshimi AZHB mund tapezullojë përkohësisht kontratën dhe pagesat, si masë paraprake deri në përfundim të hetimeve, pa ndonjë njoftim.

Neni. 8- Force majeure (forca madhore)

7.1 Sipas forcës majeure, pala është e përjashtuar nga përgjegjësitë që parashihen me këtë kontratë.

7.2 Force majeure është përcaktuar si një ngjarje e cila është e paparashikueshme dhe e pamundur për t'u shmangur nga palët pas nënshkrimit të kontratës dhe që pengon kontratën për t'u ekzekutuar.

7.3 Si force majeure mund të konsiderohen rastet siç janë: tërmetet, vërshimet, lufta, revolucionet, embargot etj.

7.4 Çdo rast, forcë majeure duhet të dëshmohet dhe pranohet nga AZHB.

Neni. 9- Komunikimi mes palëve

9.1 Çdo këmbim i informatës në lidhje me këtë kontratë duhet të jetë në formë të shkruar: direkt, me e-mail ose faks.

9.2 Njoftimet verbale nuk do të merren parasysh në qoftë se nuk janë bërë edhe njoftime në formë të shkruar siç u përmend në nenin 9.1.

**Nënshkruar nga përfaqësuesi i AZHB-së
ose**

Emri dhe Mbiemri

Nënshkruar nga përfituesi

**përfaqësuesi i tij ligjor
Emri dhe Mbiemri**

.....
Nëshkrimi
.....
Data
.....

.....
Nëshkrimi
.....
Data
.....

Pjesë e kontratës

PROCEDURAT E PROKURIMIT

(t'i bashkëngjiten kontratës së Agjencisë së pagesës, për përfituesit)

1. Dispozitat e përgjithshme të zbatueshme për të gjitha llojet e blerjeve

- Asnjë nënkontraktues i kontraktuar nga përfituesi nuk mund të kontraktojë ndonjë nënkontraktues tjetër për realizimin e kontratës;
- Blerjet duhet t'i respektojnë investimet që përmbushin kriteret epërshtatshmërisë të përcaktuara në kuadër të masave dhe udhëzimeve të planit të biznesit psh. për sa i përketkthimit të investimeve, rrjedhës së parasë etj.
- Procedurat e prokurimit vlejné vetëm për investimet e pranueshme. Për investime papranueshme nuk janë të obligueshme procedurat e prokurimit;
- Ka 3 lloje të procedurave: blerjet e drejtpërdrejta, blerjet me së paku 3 oferta dhe përzgjedhja bazuar në prokurimin me shpallje publike (tender i hapur);
- Procedura për blerjet që do të aplikohen është në varësi të vlerës së blerjeve; është e ndaluar ndarja e blerjeve për llojin e njëjtë të mallrave, punimeve apo shërbimeve me qëllim të shmangies së rregullave procedurale të aplikueshme për një prag më të lartë;
- Ofertuesi nuk duhet të jetë në konflikt të interesit;
- Ofertuesit do të përjashtohen nga dhënia e kontratave; në rastin e shtrembërimit të informacionit të kërkuar nga përfituesi ose nëse dështojnë për të dhënë këtë informacion. Respektimi i rregullave të prokurimit është kusht i detyrueshëm për t'u pranuar shpenzimet. Prandaj, dosja e kërkesës duhet të përmbajë dokumentet e pagesave për të dëshmuar plotësimin e procedurave të prokurimit, shih shtojcën 5.

2. Kriteret e dhënies së kontratës:

-Kontratat duhet të jepen duke u bazuar në këto kritere:

- A. Në rast të furnizimit me mallra**- të bazuar në çmimin më të ulët;
- B. Në rastin e ndërtimit** (nënkupton rezultatin e ndërtimit ose projektin të inxhinierisë civile që vetvetiu është e mjaftueshme të plotësojë një funksion ekonomik ose teknik dhe mbulon të dyja edhe ekzekutimin dhe dizajnimin) - bazuar në çmimin më të ulët;
- C. Në rast të shërbimeve** (studime ose për ndihmë teknike) - bazuar në çmimin më të ulët;

Përkufizimi i konfliktit të interesit

- Ekzistimi i lidhjeve ndërmjet përfituesit dhe furnizuesit (të afërm, apo aksionarë të përbashkët në kompanitë ofertuese) ose në mes të anëtarëve të Komitetit Vlerësues.
- Pronësia e përbashkët (si individë ose si aksionarë) në mesin e furnizuesve të cilët dorëzojnë oferta.

3. Procedurat e blerjes:

3.1 Blerjet direkte deri në 10000.00 €

Rregullat:

- Përfituesi mund të blejë drejtpërdrejt nga tregu,
- Kostoja e blerjes duhet të respektoj pragjet e vendosura në masë,
- Nuk ka nevojë për një kontratë të nënshkruar në mes të shfrytëzuesit dhe furnizuesit, përveç në rast të shpenzimeve të konsulencës.
- Përfituesi duhet të kërkojë dhe të pranojë kopjen e certifikatës së regjistrimit të biznesit dhe kopjen e certifikatës së numrit fiskal të ofertuesve.

3.2 Përzgjedhja bazuar në të paktën 3 oferta duke filluar prej 10000.01 € deri në 60000.00 €.

Rregullat:

- Blerjet mund të bëhet vetëm me së paku 3 oferta (kuotim i çmimit),
- Shpenzimet brenda ofertës duhet t'i respektojnë edhe pragjet e vendosura brenda masave;
- Në të gjitha rastet, duhet të nënshkruhet kontrata në mes të përfituesit dhe furnizuesit;
- Ftesat për oferta, ofertat dhe kontrata duhet t'i respektojnë dispozitat/detajet e të cilave janë paraqitur në kuadër të projektit teknik dhe brenda planit të biznesit;
- Përfituesi duhet të dërgojë një ftesë për oferta, duke respektuar një format standard. Shih shtojcën nr. 1 të kontratës;
- Furnizuesit duhet ta regjistrojnë ofertën e tyre në regjistrin e hyrje/daljeve;
- Përfituesi duhet të nënshkruajë deklaratën për respektimin e rregullave për shmangien e konfliktit të interesit - shih shtojcën nr. 2 të kontratës;
- Ofertuesit duhet të nënshkruajnë deklaratën e tenderuesit të besueshëm - shih shtojcën nr. 3;
- Përfituesi do të vendosë për dhënien e kontratës ofertuesit me argumente;
- Përfituesi duhet të kërkojë dhe të pranojë kopjen e certifikatës së Regjistrimit të Biznesit dhe kopjen e certifikatës së numrit fiskal të ofertuesve.

3.3 Prokurimi me shpallje publike (tender i hapur) - duke filluar me 60000.01€

Rregullat:

- Të gjitha dispozitat nga pika 4.2. duhet të respektohen;
- Përfituesi duhet ta publikojë interesin e tij për blerjen përmes së paku 1 gazete të përditshme kombëtare,por në qoftë se vlera është më e lartë se 150000 €, tenderi duhet të paraqitet edhe në mediet ndërkombëtare. Përveç kësaj,përfituesi ka të drejtë të dërgojë direkt ftesat për furnizuesit e mundshëm për të siguruar një konkurrencë më të mirë në mesin e ofertave,por vetëm në të njëjtën ditë kur është shpallur tenderi;
- Përmbajtja e ftesës publike duhet të përfshijë të gjithë informacionin e paraqitur në shtojcën1;
- Afati kohor për marrjen e ofertave duhet të jetë të paktën 10 ditë;
- Përfituesi do të krijojë një komision vlerësimi; Ky komision duhet të ketë një numërtëk të anëtarëve,të paktën tre,me të gjitha kapacitetet teknike dhe administrative të nevojshme për të dhënë një opinion të vlefshëm mbi tenderët;
- Komisioni i vlerësimit duhet ta lëshojë një vendim të argumentuar për dhënien e tenderit;
- Anëtarët e komisionit të vlerësimit duhet të nënshkruajnë një deklaratë të konfidencialitetit dhe neutralitetit-shih shtojcën 4.
- Të gjitha kërkesat për pjesëmarrje dhe tenderët që i plotësojnë kërkesat, duhet të vlerësohen dhe renditen nga komisioni i vlerësimit në bazë të kriterëve të përzgjedhjes dhe dhënies së kontratës të shpallura paraprakisht.
- Përfituesi duhet të kërkojë dhe të pranojë kopjen e certifikatës së regjistrimit të biznesit dhe kopjen e certifikatës së numrit fiskal të ofertuesve.

Shtojca 1. e kontratës **Ftesë për dorëzimin e një oferte**

Emri i përfituesit

privat.....

Numri i regjistrimit të biznesit ose numri personal i identifikimit.....

Numrit

fiskal.....

Adresa.....

Fix. tel./fax/e-

mail.....Nr.....Data.....

Për: Emri i

kompanisë.....E

pranuar sot:

Nr.....Data.....

Emri dhe Mbiemri:.....

Nr i Regjistrimit të Biznesit.....

Numri Fiskal.....

Nënshkrimi.....

**Ftesë për dorëzimin e një ofertë
(Formular)**

Të nderuar Zonja/Zotërinj,

